



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 9 KORRIK 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

2. Raporti vjetor i veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2017 *(neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet titullari i institucionit *(jo më shumë se 60 minuta)*.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Pyetje

Diskutime *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi ose 10 deputetë)*

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

3. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” *(nenet 73-77, Rregullore, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

4. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin European.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

5. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”) *(neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

7. Projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e Sistemit për Krahësimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES)” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

8. Projektligji “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, për zbatimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

9. Për votim: projektligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

10. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës *(neni 45 i Rregullores)*

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta.

Gramoz Ruçi – Ju lutem, kolegë, uluni, fillojmë seancën!

Seancën e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës)

Ju njoftoj se nga institucionet e vetëqeverisjes, konkretisht nga komisionerët publikë është depozituar në Kuvend kërkesa për një shtesë të numrit të punonjësve dhe riklasifikim të pagave të administratës së këtij institucioni.

Njëherësh ju njoftoj se dy kryetarët e grupeve parlamentare, zoti Spaho dhe zoti Vasili, i kanë drejtuar Kryetarit të Kuvendit një kërkesë për votimin e datës 06.07.2018, ku theksohet se ka shkelje të Kushtetutës, të ligjit dhe të Rregullores së Kuvendit, gjithashtu ka kontestime për votimin. Prandaj kërkohet zbatimi i nenit 61 të Rregullores, të cilin po jua citoj: “Çdo votim i kryer në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin ose Rregulloren e Kuvendit është i pavlefshëm. Drejtuesi i seancës, pasi merr mendimin e Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet, urdhëron anulimin e votimit dhe përsëritjen menjëherë të tij”.

Unë sot jam njohur me këtë kërkesë, prandaj kam autorizuar dhe kam vënë shënimin që të mblidhet Sekretariati për Procedurat dhe Votimin, të investigojë lidhur me pretendimet e ngritura nga dy kryetarët e grupeve parlamentare, të na japë mendimin dhe mbi bazën e mendimit të Sekretariatit, sigurisht unë do të kem një qëndrim në përfundim të investigimit që do të bëjë komisioni përkatës.

Fillojmë me raportin vjetor të veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2017.

Po, zoti Vasili.

Petrit Vasili – Zoti Kryetar,

Ju cituat kërkesën që ne kemi bërë, e cila qartëson që në sallën e Kuvendit tashmë çdo standard i funksionimit ka rënë. Është në vijimësi të të njëjtit standard, i cili i hoqi mundësinë 2 javë më parë opozitës të vazhdonte të fliste. Në përputhje me Rregulloren, kërkesa jonë, për shkak të kësaj seance, e cila është kërkuar pikërisht nga ju për t'u zhvilluar ditën e hënë, është depozituar 2 ditë më parë, edhe më shumë, sikurse e kërkon edhe Rregullorja.

Pra, ka qenë gjithë koha e nevojshme për të bërë investigimin e duhur për këtë çështje, pasi është fare e qartë që parlamenti nuk mund të funksionojë si në ditët e tjera. Përderisa seanca po zhvillohet ditën e hënë, investigimi duhet të ishte bërë. Është një standard mjaft i ulët, i cili u verifikua më në fund në sallën e parlamentit, ku vota u tjetërsua në mënyrën më të turpshme që mundet dhe për ne është e papranueshme dhe e patolerueshme që në këtë situatë të vazhdojmë të bëjmë sikur nuk ka ndodhur asgjë, të jemi këtu dhe të ligjërojmë pikërisht këtë gjë, e cila ishte një emergjencë që duhej të verifikohet dhe seanca nuk duhej të hapej...

Gramoz Ruçi – Ju lutem, kolegë, ta dëgjojmë zotin Vasili!

Petrit Vasili – Gramoz, qetësoji që të flasim edhe ne.

Pikërisht për këto arsye kjo situatë e papranueshme bën pikërisht këtë gjë, që ne të mos vazhdojmë dot së bashku, derisa kjo situatë të sqarohet dhe ky rivotim të kryhet.

Gramoz Ruçi – Zoti Spaho e ka fjalën.

Edmond Spaho – Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe unë dëshiroj ta mbështes qëndrimin e kolegut Vasili.

Ditën e enjte është kryer votimi për shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar me një akt të paprecedentë, por më shumë se përmbajtja e ligjit, edhe vetë procesi i votimit ka pasur defekte, rezultati është manipuluar. Një prej deputetëve të opozitës, i cili nuk ka qenë prezent në sallë, rezulton të ketë votuar pro ligjit për shembjen e Teatrit. Sikurse e tha edhe kolegu Vasili, nuk është hera e parë që në këtë Kuvend ndodhin çudira të tilla, edhe në të shkuarën ne

jemi privuar nga e drejta për të folur nëpërmjet vullnetit të shumicës.

Kërkesa jonë për ta anuluar votimin, për ta rivotuar ligjin është bërë para dy ditësh, duke qenë se çështja është urgjente dhe mjaft e rëndësishme, shumë e rëndësishme. Nuk e besoj të ketë ndonjë gjë më të rëndësishme sesa pretendimi nga opozita për manipulimin e rezultatit të votimit për një ligj special, të veçantë madje.

Kështu që e para gjë që duhej të bënte Kuvendi, gjatë këtyre dy ditëve, deri në seancën e sotme, do të ishte verifikimi i pretendimeve të opozitës dhe sot të kishim një përgjigje të qartë për çfarë ka ndodhur.

Të ndodhur në këtë situatë dhe në këto kushte, ne si opozitë nuk do të marrim pjesë në seancën e sotme, për shkak se gjendje të tilla në Kuvendin e Shqipërisë po bëhen të zakonshme, opozita jo vetëm po privohet nga e drejta e fjalës, por më keq, vullneti i saj po denatyrohet nëpërmjet mekanizmave të tillë, të cilët falsifikojnë votimin e një ligji kaq të rëndësishëm dhe të kontestuar nga një pjesë e madhe e opinionit publik.

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Edhe një herë, në zbatim të Rregullores përkatëse, siç jua thashë, ju keni bërë një kërkesë, është e drejta juaj, por unë kërkesën sot e kam marrë si Kryetar i Kuvendit. Ju e keni depozituar vërtet para 2 ditësh, por në orën e fundit të orarit zyrtar, pasi ditën e shtunë dhe të diel administrata nuk funksionon. Unë sot, që në orët e para të mëngjesit, kam vënë shënimin që Sekretariati për Votimin, i përfaqësuar konkretisht nga zoti Hyseni, zoti Shamenti dhe zoti Alibeaj, si dhe i kam dhënë porosi administratës të vërë në dispozicion gjithë dokumentacionin dhe pamjet filmike të sallës, ta shqyrtojë çështjen dhe të japë mendimin dhe mbi bazën e mendimit të tyre do të marr vendimin përkatës.

Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Zoti Kryetar,

Në fakt, nuk kam asgjë me procedurën, sepse procedura që ju po ndiqni është korrekte. Ka ndodhur edhe në disa raste të tjera në Kuvendin e Shqipërisë, ku ka një kërkesë që lidhet me procedurën e votimit dhe është Sekretariati i Votimit ai që adreson kërkesën. Por përpara se ky *fake news* të bëjë xhiron e të gjitha

rrjeteve, dua ta sqaroj opinionin publik se nga ana e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste nuk ka pasur asnjë deputet që të ketë votuar në emër të një deputeti tjetër, sikurse për transparencë të opinionit publik, deputetit të pavarur Robert Bitri në vendin që ai voton i është vënë karta e një deputeti tjetër dhe sigurisht që kamerat apo shërbimet e Kuvendit le ta hetojnë dhe t'i shkojnë deri në fund kësaj çështjeje.

Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratike kanë detyrimin t'i thonë opinionit publik arsyen e vërtetë të bojkotit të kësaj seance. Bojkotimi i kësaj seance nuk ka të bëjë fare me kërkesën, sepse 75, apo 74 vota nuk është ndryshim i madh. Nëse e drejta e zotit Bitri është mohuar me pa të drejtë, sepse, në fund të fundit, një deputet ka votuar në atë pjesë të sallës, ku nuk ka asnjë deputet socialist, çfarë dhe kush fshihet pas këtij skenari gjoja për të prishur votimin e ditës së enjte? Të gjithë e kuptojmë, le t'i hedhim një sy axhendës parlamentare të ditës së sotme, e pavarësisht kësaj, unë përsëri i bëj thirrje, në radhë të parë Lëvizjes Socialiste për Integrim, nuk kam asnjë dyshim që Partia Demokratike është kundër, se sot ne duhet ta votojmë ligjin për Shkollën e Magjistraturës.

Sot Shqipëria duhet të japë një mesazh tjetër në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian, që detyrimet tona përkundrejt implementimit të mëtejshëm të reformës në drejtësi duhet të vijojnë. Kjo është arsyeja e këtij bojkoti!

Për sa i përket procedurës, dy anëtarët tanë të Sekretariatit të Votimit, zoti Kryetar, janë të gatshëm ta marrin dhe ta shqyrtojnë kërkesën, por Partia Demokratike të paktën të ushtrojë kompetencën dhe të drejtën që me kërkesën e saj të sjellë anëtarin e vet që ka në Sekretariatin e Votimit për t'u mbledhur ky Sekretariat.

Këta jo vetëm që bojkotojnë seancën, por bojkotojnë edhe sekretariatin për të shqyrtuar kërkesën që ata kanë bërë po vetë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Vazhdojmë seancën.

Sekretariati të krijojë kuorumin përkatës dhe të shqyrtojë kërkesën e bërë nga dy grupet parlamentare. Shërbimet e Kuvendit të vënë në dispozicion të gjitha materialet që do të kërkojë Sekretariati për Votimin.

Fillojmë me çështjen e parë, raporti vjetor i veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2017.

Ftoj kryetarin e bordit, zotin Petrit Ahmetaj për të mbajtur raportin.

Petrit Ahmetaj - Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Në emër të Entit Rregullator të Energjisë ju paraqes raportin vjetor për aktivitetin e këtij institucioni gjatë vitit 2017, në fushën e rregullimit të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në vendin tonë. Në këtë raport paraqitet në mënyrë të detajuar edhe aktiviteti i Entit Rregullator, si dhe ofrohet një informacion i përditësuar për zbatimin e legjislacionit në fushën e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet realizimit të detyrave dhe objektivave të shprehura në rezolutën e Kuvendit për veprimtarinë e ERE-s gjatë vitit 2016.

Enti Rregullator i Energjisë aktivitetin e tij rregullator e mbështet në ligjin nr.43/2015 për sektorin e energjisë elektrike dhe ligjin nr. 102/2015 për sektorin e gazit natyror. Ky institucion është në varësi të parlamentit shqiptar dhe ka pavarësi të plotë financiare nga buxheti i shtetit.

Gjatë vitit 2017 sektori i energjisë tregoi një qëndrueshmëri ndaj aktivitetit të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, duke mbajtur dhe ruajtur parametra optimalë në operimin fizik dhe rezultate shumë të mira financiare. Po ashtu edhe sektori i gazit natyror pati zhvillime në strukturimin e tij.

Si një institucion i krijuar me ligj dhe në përputhje me besimin e dhënë nga organi më i lartë legjislativ, jemi përkushtuar në misionin tonë për të siguruar që shërbimet e rregulluara të ofrojnë shërbime të sigurt dhe të besueshme, bazuar në kosto të drejta dhe të arsyeshme. Në përmbushje të misionit tonë, ne ushtrojmë veprimtarinë në një mënyrë të hapur dhe transparente duke synuar ekuilibrimin e interesave të konsumatorëve, shtetit dhe investitorëve në sektorët që ERE-ja rregullon.

Raporti për sektorin e energjisë në Shqipëri përfshin një pasqyrim të situatës dhe aktiviteteve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në tregjet përkatëse, në sigurinë e furnizimit me energji dhe gaz natyror dhe në

mbrojtjen e konsumatorëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Për sa i përket strukturës dhe përmbajtjes, raporti është, gjithashtu, në përputhje me përcaktimet e ligjeve dhe me rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë.

Të gjitha vendimet, brenda kompetencës së Entit Rregullator, miratohen nga bordi. Në vitin 2017 bordi ka marrë 214 vendime në 34 mbledhje të zhvilluara, në përputhje me rregullat e organizimit të ERE-s. Këto vendime kanë qenë produkt i analizave gjatë trajtimit të çështjeve të tilla, si: rregullimi i çmimeve, miratimi i rregullave për plotësimin e kuadrit rregullator, kërkesat për licencim, certifikimi i OST-së dhe “Albgaz”-it si dhe çështje të tjera brenda juridiksionit të ERE-s.

Siguria e furnizimit me energji elektrike në vitin 2017 ka qenë në qendër të punës së ERE-s dhe operatorëve që sigurojnë shërbimet publike në këtë sektor. Konsumi total i energjisë elektrike për vitin 2017 është rritur me 4,9%, krahasuar me vitin 2016; konsumi i klientëve familjarë u rrit me rreth 2,6%. Në tregun e hapur me çmimet e tregut është blerë rreth 39,6% e energjisë elektrike të konsumuar në vend.

Së fundi, nëpërmjet plotësimit të kuadrit nënligjor dhe investimeve në sistemin e matjes është bërë e mundur shkëputja nga tregu i rregulluar i klientëve të lidhur në sistemin 35 kilovolt.

Në vitin 2017 treguesit teknikë të cilësisë të furnizimit me energji elektrike u përmirësuan më tej.

Për sa u takon çmimeve të energjisë elektrike në vitin 2017, referuar vendimit të ERE-s, janë ruajtur të pandryshuara çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundorë. Gjatë vitit 2017 është realizuar ndarja ligjore dhe pronësore e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe është punuar për të finalizuar ndarjen ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nga ai i furnizimit të shërbimit universal, e cila, së fundi, u realizua me themelimin e tri shoqërive aksionere: furnizuesi i shërbimit universal; furnizuesi i tregut të lirë dhe operatori i sistemit të shpërndarjes.

Zhvillimi i tregut të gazit është gjithashtu një nga sfidat e sektorit. Tubacioni i gazsjellësit “TAP” është projekti më i rëndësishëm për të

cilin ka vijuar puna e ERE-s në bashkëpunim me dy rregullatorët italianë dhe grekë, vende ku kalongazsjellësi. Aktualisht në zbatim të detyrimeve që burojnë nga traktati i Komunitetit të Energjisë jemi fokusuar në implementimin e vendimeve të grupit të përhershëm të nivelit të lartë të Komunitetit të Energjisë, që kanë të bëjnë me kushtet për akses në rrjetet e transmetimit të gazit natyror.

Ndryshimet e miratuara në ligjin për sektorin e energjisë janë një hap i rëndësishëm që vendos bazat për themelin e Bursës së Energjisë Elektrike Shqiptare, si shoqëri anonime e Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

Tregu i energjisë elektrike për vitin 2017 ka funksionuar bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 30.03.2016, për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohet ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike.

Me hyrjen në fuqi të ligjit për sektorin e energjisë Enti Rregullator i Energjisë ka vijuar punën për miratimin e akteve rregullatore nënligjore në zbatim të tij. Me vendimin nr. 519, datë 13.07.2016, Këshilli i Ministrave në zbatim të nenit 93, pika 3, të këtij ligji, ka miratuar modelin e tregut në bazë të të cilit ERE, me vendimin nr.214, të bordit ka miratuar rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe marrëveshjen e pjesëmarrjes në Bursën Shqiptare të Energjisë.

Veprimtaria e “OST sha” e transmetimit të energjisë elektrike kryhet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, OST, një shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore. “OST sha” është krijuar në vitin 2004 si rezultat e ndërhyrjes në Korporatën Elektroenergjetike nga një shoqëri e organizuar vertikalisht, që kryen edhe funksionet e gjenerimit, të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në tri shoqëri të veçanta.

“OST sha” kryen funksionet e operatorit të rrjetit të sistemit, operatorit të sistemit të dispeçerimit dhe operatorit të tregut. “OST sha” garanton kapacitetet e nevojshme për furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes, si dhe të klientëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit, transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e

vendit, si dhe tranzitimin dhe shkëmbimet e nevojshme të energjisë elektrike në vendet rajonit. Në këtë kuadër, ai zhvillon sistemin e transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike. Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike përfshin të gjitha linjat me tension 400 kilovolt, 220 dhe 110 kilovolt dhe nënstacionet lidhëse mes tyre.

Në lidhje me funksionin e sistemit të transmetimit, për vitin 2017 rezultoi se sistemi në tërësi nuk është ballafaquar me avari të rënda ose ngjarje të parashikuara të shoqëruara me ndërprerjen ose kufizimin e energjisë elektrike. Një nga detyrat kryesore të OST-së është zbulimi i aftësisë afatgjatë të sistemit për të plotësuar kërkesën për transmetimin e energjisë elektrike, duke operuar, ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të sigurtë dhe të besueshme dhe efikase sistemin e transmetimit. Duhet theksuar se me vënien në punë të linjës 400 kilovolt Elbasan-Tiranë-Podgoricë dhe 400 kolovolt, 220 dhe 110 Tiranë, siguria e operatorit të sistemit është rritur jashtë mase.

Shpërndarja e energjisë elektrike kryhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i licencuar nga ERE sipas dispozitave të ligjit për sektorin e energjisë elektrike. Operatori i sistemit të shpërndarjes është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes, përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe është i organizuar në 11 zona shpërndarjeje dhe 42 agjenci.

Nga studimi i profilit vjetor të konsumit të energjisë elektrike, e para karakteristikë e këtij profili është simetria thuhet e plotë e konsumit dimër-verë. Ashtu sikurse në raportimet e viteve të mëparshme, edhe këtë vit vërehet i njëjti fenomen, ai i përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje në dimër, sepse çdo ndryshim i temperaturës së mjedisit reflektohet menjëherë në konsumin ditor të energjisë elektrike, pikërisht për efekt të përdorimit ose mospërdorimit të ngrohjes me energji elektrike.

Projekti “TransAdriatik”, TAP i gazsjellësit është një projekt madhor, i cili është një pjesë e sistemit të transmetimit të gazit të prodhuar nga vendburime në Azerbajxhan drejt tregut evropian të gazit. Transportimi nëpërmjet Azerbajxhanit dhe Gjeorgjisë do të krijohet me

një tubacion që do të kalojë në San Kaukaz, ndërsa transportimi përmes Turqisë do të kryhet me anë të tubacionit. Transportimi i mëtejshëm do të kryhet me anë të tubacionit “Trans Adriatik”, që do të kalojë përmes Shqipërisë, Greqisë dhe detit Adriatik në drejtim të Italisë.

Dihet se territori, ku do të merret kjo sasi gazi është nga më të mëdhatë, krahasuar me Europën, Afrikën Veriore dhe Rusinë. Enti Rregullator i Energjisë të Shqipërisë, së bashku me Entin Rregullator të Greqisë dhe Italisë, janë në koherencë të plotë në marrëdhënien e përditshme me projektin dhe kanë marrë vendime të përbashkëta në lidhje me projektin TAP. Këto vendime janë marrë në përputhje me direktivën e Parlamentit Europian, të Këshillit të Ministrave dhe me rregulloren e Komunitetit të Energjisë.

Certifikimi i operatorit të sistemit të Transmetimit “Albgaz”, vendimi më i rëndësishëm gjatë vitit 2017 është certifikimi i “Albgaz”-it, si operator i kombinuar për transmetim dhe shpërndarjen në përputhje të plotë me direktivën 2009/73 të Komunitetit të Energjisë dhe të Parlamentit Europian. Është ERE ajo që përcakton kërkesat për aplikim, certifikim të operatorit të kombinuar, përfshirë edhe dokumentacionin e nevojshëm që provon përmbushjen e kushteve të ligjit. Aplikimi për certifikimin paraqitet nga operator, i kombinuar në përputhje me kërkesat e miratuara nga ERE. Rregullat për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror janë të miratuara edhe nga bordi i komisionerëve të Entit Rregullator.

Një nga aspektet më të rëndësishme të punës së Entit Rregullator është edhe realizimi i detyrave të lëna nga rezoluta e këtij parlamenti. Në lidhje me kërkesën për miratimin e tarifave të reja, ku i kushtohet një vëmendje e veçantë, nga njëra anë, mbrojtjes së konsumatorëve për tarifa me çmime sa më të drejta dhe të përballueshme dhe, nga ana tjetër, rritjes së cilësisë së shërbimit dhe performancës së kompanisë, sqarojmë se edhe vendimi nr. 52, datë 06.04.2017, vendosi lënie në fuqi të vendimit nr 190, datë 22.12.2016 të bordit të ERE-s deri në 31.10.2017. Ministria e Energjisë ka bërë me dije se mbajtja e të njëjtës tarifë do të garantonte zhvillimin normal të aktivitetit të shoqërive deri në përmbyllje të proceseve në kuadër të

reformave sektoriale. Në këto rrethana, për bazën e argumentit për mjaftueshmërinë e të ardhurave të shoqërive “KESH”, ose “OST” dhe “OSHEE”, u vlerësua mbajtja e të njëjtit regjim tarifor për vazhdimësinë normale të veprimtarisë së tyre edhe për vitin 2017.

Zhvillimet në implementimin e reformës në sektorin e energjisë u kurorëzuan me miratimin e 4 ligjeve bashkëkohore për këtë sektor, si: ligji për energjinë elektrike; ligji për gazin natyror; ligji për energjinë e rinovueshme dhe ligji i eficiencës së energjisë. Këto akte kryesisht janë: kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët tariforë; rregullorja për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike metodologjisë së llogaritjes së rimbursimit të dëmit ekonomik nga operatori i sistemit rregullator dhe rregullorja mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klientët dyshojnë në saktësinë e të dhënave të aparatit matës.

Rezoluta fokusohet, gjithashtu, në vendosjen e detyrave ndaj ERE-s, siç janë: të rrisë përpjekjet e saj në ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre që lidhen me shërbimin e furnizimit me energji elektrike, përmes publikimeve në faqen *online* të institucionit, si dhe mjeteve të tjera të komunikimit; të kërkojë nga kompania “OSHEE” anulimin e faturave të konsumatorëve nën emërtimin “dëm ekonomik” dhe energji e pamatur në periudhën 2008-2011, në zbatim të vendimit përkatës të ERE-s.

Me gjithë uljen e ndjeshme të numrit të ankesave të konsumatorëve, krahasuar me një vit më parë, vijoi trajtimi me seriozitet i tyre, duke kërkuar, njëkohësisht, një përgjegjshmëri më të lartë nga OSHEE.

Në përmirësimin e kujdesit për konsumatorin, është përfunduar rregullorja e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit të konsumatorëve. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe jemi fokusuar edhe në intensifikimin e monitorimit të të gjitha segmenteve të sektorit për të raportuar rezultatet dhe masat që përmirësojnë situatën. Për periudhën janardhjetor 2017 OSHEE-ja i ka rritur arkëtimet nga faturat e energjisë elektrike, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Norma e

arkëtimin ndaj faturës pararendëse është rritur, sasia e energjisë elektrike të shitur rezultoi me rritje, që është bërë e mundur nga rritja e kontrolleve në terren dhe nga ulja e abuzimit. OSHEE-ja vazhdon të ulë, gjithashtu, edhe nivelin e humbjeve teknike dhe joteknike të rrjetit. Falë investimeve në rrjetin e tensionit të mesëm dhe të ulët, humbjet përgjatë vitit 2017 kanë arritur në 26,41%.

Ecuria pozitive vihet re edhe në treguesit e reduktimit të nivelit të borxhit të keq, i cili rezultoi i ulët. Në rezolutë kërkohej, gjithashtu që ERE-ja të marrë masat e nevojshme për plotësimin e kuadrit të legjislacionit sekondar në përputhje me rregullat dhe direktivat përkatëse të BE-së, të domosdoshme për certifikimin e “Albgazit”, si operatori i transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror. Ky certifikim i paraprin hapin tjetër të rëndësishëm, që është dhënia e licencës së aktivitetit operatorit të transmetimit dhe shpërndarjes “Albgaz”.

Vlen të theksohet se bordi i ERE-s, me vendimin nr. 82, datë 26.05.2017, ka miratuar certifikimin paraprak të shoqërisë “Albgaz” në cilësinë e operatorit të kombinuar të gazit natyror, dhe me vendimin nr. 10, datë 07.06.2017, ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz sh.a” për periudhën 05.01.2017-20.09.2017.

Nga ana tjetër, ligji për sektorin e gazit natyror vendos parakushtin se subjekti që aplikon për një licencë në transmetimin e gazit natyror, duhet që më parë të certifikohet, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 37 të ligjit nr. 102 të vitit 2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

Licencimi dhe monitorimi i veprimtarisë në tregun e energjisë elektrike

Licencimi dhe kërkesat e trajtuara gjatë vitit 2017

Gjatë vitit 2017 ERE-ja ka kryer një veprimtari të gjerë për licencimin e subjekteve në aktivitete të ndryshme të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, për të gjitha aplikimet e paraqitura, është respektuar transparenca e parashikuar në procedurat për licencimin, në zbatim të ligjit nr. 43 të vitit 2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe të ligjit “Për gazin natyror”.

Monitorimi i tregut të energjisë elektrike

Monitorimet janë kryer bazuar në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar”” dhe VKM-në nr. 242, datë 30.3.2016, në bazë të të cilave veprojnë pjesëmarrësit e tregut, mbledhja dhe përpunimi i rezultateve periodike, përpunimi i rezultateve të marra nga operatorët, apo të konstatuara nga monitorimi në terren, identifikimi i çështjeve për monitorim në terren, monitorimi për zbatimin e rregulloreve, si dhe kryerja e monitorimeve në terren dhe analizat e tyre.

ERE-ja në bashkëpunim me USAID-in, është në fazën e përfundimit të përgatitjes për ndërtimin e një platforme elektronike për të gjithë sektorin, e cila do t’i detyrojë pjesëmarrësit në tregun e energjisë të plotësojnë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga direktivat, nga rregulloret e Komunitetit të Energjisë, si dhe nga ligji i sektorit të energjisë elektrike e gazit natyror.

Aktiviteti i ERE-s në fushën e rregullimit të tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike dhe gazit natyror

Bazuar në ligjin për sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror, ERE-ja është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për veprimtaritë e rregulluara dhe për ata që kanë detyrimin e shërbimit publik në sektorin e energjisë, bazuar në metodologjitë e aprovuara.

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, veprimtaritë kryesore të ERE-s gjatë vitit 2017 ishin: shqyrtimi i aplikimeve për tarifën dhe çmimet nga ana e të licencuarve në sektorin elektroenergjetik dhe të gazit natyror; hartimi i metodologjive për llogaritjen e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike, tarifave të operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë, dhe çmimeve të shitjes së energjisë elektrike edhe nga furnizuesit e mundësisë së fundit.

Tarifa për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror

Bordi i ERE-s me vendimet nr. 191 dhe 192 të datës 22.12.2016 filloi procedurat për shqyrtimin e aplikimit të kompanive, të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Bordi i ERE-s mori vendimin për të filluar me iniciativën e vet procedurat për përcaktimin e

tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe është e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik KESH për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017.

Në zbatim të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, përgjatë procesit të shqyrtimit të këtyre praktikave u kryen veprimet e nevojshme procedurale për të siguruar transparencën nëpërmjet publikimeve dhe seancave dëgjimore. Nga analizat e kryera dhe informacioni tekniko-ekonomik, ERE-ja konstatoi se gjatë viteve 2015-2016 të tria shoqëritë kishin krijuar rezerva, të cilat u gjykuan të mjaftueshme për zhvillimin normal të aktivitetit për periudhën pasardhëse. Ky konstatim u konfirmua edhe nga rezultati financiar pozitiv në pasqyrat financiare për tri kompanitë për periudhën 2015-2016. Për këtë arsye u vendos shtyrja deri më 31.12.2017 e fuqisë juridike të vendimit nr. 190, datë 22.12.2016 të bordit të ERE-s për lënien në fuqi të tarifave dhe çmimeve të përkohshme të energjisë elektrike të miratuar me vendimin nr. 139.

Prodhuësi me përparësi të energjisë elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, ku përfshihen HEC-et me fuqi deri në 15 megavat, në vitin 2017 pësoi një ulje prej rreth 27%, krahasuar me vitin 2016. Ndikimi kryesor në rënien e prodhimit nga këta prodhues ishin prurjet e pakta hidrike gjatë vitit 2017. Tendencë në rritje e prodhimit të energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi ku, përveç shtimit të kapaciteteve prodhuese të impianteve hidro në të ardhmen, parashikohet të fillojë prodhimi edhe i impianteve fotovoltaike dhe eolike, si dhe inceneratorët, që kanë lëndë të parë pjesën biodegraduese të mbetjeve të ngurta urbane.

Aktiviteti i ERE-s në zhvillimin e legjislacionit sekondar dhe ndryshimet e tjera të bëra në ligj

Një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së ERE-s është edhe hartimi i legjislacionit sekondar, që përbën dhe kuadrin rregullator në sektorin e energjisë elektrike. Ky kuadër është plotësuar nga ERE-ja në një pjesë të konsiderueshme dhe, aktualisht, janë ende në proces përpunimi nga ERE-ja i disa akteve të

rëndësishme në zbatim të ligjit nr. 43 të vitit 2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit “Për gazin natyror”.

Hartimi dhe rishikimi i akteve nënligjore nga ana e ERE-s është bërë në çdo rast duke u konsultuar gjerësisht me palët e treta, që kanë pasur interes të drejtpërdrejtë mbi këto vendimmarrje. Vlen të përmend faktin se në çdo rast fillimi i procedurës për shqyrtimin e një akti nënligjor nga ana e ERE-s është njoftuar në mediet e shkruara për t’i dhënë mundësi njohjeje publikut, si dhe për të marrë mendimin e tyre.

Zhvillimi i seancave dëgjimore në prezencë të palëve, që kanë shfaqur interes për dokumentet në proces përpunimi nga ERE-ja, në çdo rast është bërë publik nga palët e interesuara.

Në çdo rast aktet e miratuara nga ERE-ja janë konsultuar me Autoritetin e Konkurrencës, Ministrinë përgjegjëse për Energjinë, si dhe me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, me të cilin ne mbajmë një lidhje permanente për të gjitha vendimet që merr ERE-ja. Kjo për një arsye shumë të thjeshtë, sepse aktualisht ne jemi në koherencë të plotë me të gjithë legjislacionin e BE-së.

Veprimtaria e ERE-së në fushën e mbrojtjes së konsumatorit

Në funksion të detyrave të saj, ERE-ja ka analizuar të dhënat lidhur me numrin e ankesave të klientëve të paraqitur gjatë vitit 2017 dhe ka evidentuar se ky numër është shumë më i vogël krahasuar me vitin 2016. Për vitin 2016 në ERE janë paraqitur për trajtim 957 ankesa, ndërsa gjatë vitit 2017 këto ankesa shkuan në 564. Përveç objekteve të saj, ERE-ja ka ofruar asistencë edhe në dhënien e informacionit, të shpjegimeve dhe ankesave të paraqitura nga konsumatori.

Administrimi i burimeve financiare dhe njerëzore

Edhe për vitin 2017 për sa i takon fushës së burimeve njerëzore është zbatuar me përpikëri ligji nr. 93/64, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. ERE-ja ushtron përgjegjësitë e saj në zbatim të ligjit nr. 43 të vitit 2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i cili ndihmohet në punën e tij nga një staf teknik mbështetës, që është shumë i specializuar. Në raportet vjetore të implementimit të paraqitura nga Sekretariati

Komunitetit të Energjisë në pjesën “Shqipëria dhe konkluzionet” ky organizëm ka theksuar, ndër të tjera prioritet kyçe për ERE-n, si më poshtë:

Zgjerimi më tej i përgjegjësisë dhe kompetencave të ERE-s në kuadër të implementimit të objektivave dhe parimeve të përcaktuara në paketën e tretë të energjisë.

ERE-ja duhet ta forcojë më shumë pavarësinë e saj, pagat e stafit të ERE-s duhet t’u korrespondojnë niveleve të pagave të rregulluara të kompanive dhe duhet të përcaktohen totalisht nga vetë rregullatori.

Finalizimi i procesit të miratimit të ndryshimeve të ligjit nr. 95/84, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” përbën një hap të domosdoshëm për qëllimet e implementimit të pavarësisë financiare të ERE-s.

Duke e konsideruar zhvillimin në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në përputhje me kërkesat më kualitative, të cilat përputhen plotësisht me ato të BE-së ku, ndër të tjera ERE-ja zhvillohet si një institucion i pavarur me kapacitete të mjaftueshme dhe me ekspertizën e nevojshme për t’u përballur me sfidat e sektorit, është me rëndësi rishikimi i strukturës organizative të ERE-s, si dhe pavarësia operacionale e stafit të saj.

Për vitin e ardhshëm objektivat e ERE-s janë orientuar në përputhje me sfidat që lidhen me vijimin e punës, siç është liberalizimi i tregut të energjisë elektrike, ngritja dhe bërja efektive e bursës dhe i mekanizmave të paparashikuara në kuadër të nismave rajonale, konkretisht *Western Balkans 6*.

Vitet e fundit, siç edhe kemi raportuar më parë, janë kryer një sërë investimesh me rëndësi kryesisht në rrjetin e amortizuar të shpërndarjes. Edhe për vitin në vazhdim ERE-ja do të ndjekë me prioritet procesin që lidhet me shqyrtimin dhe miratimin e planit të investimeve tek operatorët kryesorë, ata të shpërndarjes dhe tek Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

Në thelb të këtij procesi qëndron planifikimi me kujdes i investimeve të orientuara në uljen e kostove, në identifikimin e pjesëve të sistemit, ku ndërhyrja është më e nevojshme, për

të vijuar me segmentet e tjera, që lidhen me kërkesat për një sistem të integruar të tregut rajonal.

Një nga prioritetet e ERE-s për vitin që mbyllëm, por edhe në vijim, mbetet reflektimi në legjislacionin aktual rregullator i ndryshimeve, të cilat do të jenë në përputhje me paketën e tretë të BE-së në fushën e energjisë. Kjo do të bëjë të mundur krijimin e një tregu konkurrues dhe eficient që rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në vend dhe e integron atë në tregun rajonal. Për këtë qëllim ERE-ja ka vendosur një bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë, Ministrinë përgjegjëse për Energjinë dhe Autoritetin e Konkurrencës lidhur me çështje që kanë të bëjnë me kuadrin rregullator në sektorin e energjisë, por edhe me çështje të tjera të rëndësishme të këtij sektori.

Në përfundim, duke falënderuar të gjitha institucionet, organizmat me të cilët ERE-ja bashkëpunon, shpresojmë që ky raport vjetor të shërbejë si një informacion i dobishëm e i qartë i të dhënave jo vetëm për institucionin e Kuvendit, por edhe për të gjitha institucionet, organizmat, investitorët, konsumatorët dhe çdo person të interesuar për tregun e energjisë.

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ahmeti!

Pyetje nuk ka, as kërkesë për diskutime, prandaj jeni i lirë, zoti Ahmeti.

Vazhdojmë me projektligjet e tjera të rendit të ditës. Konkretisht, lidhur me projektligjet “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 23.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”;; “Për një shtesë në ligjin nr. 92, të vitit 2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”;; “Për një shtesë në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”;;, që janë pjesë e paketës fiskale dhe diskutimi do të bëhet për të tria bashkë.

Kanë depozituar emrat për diskutim zotërinjtë: Erion Braçe, Taulant Balla, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Beqaj, Arben Pëllumbi, Antoneta Dhima, Xhevit Bushaj dhe Roland Xhelilaj. Në emër të Grupit të Parlamentar të PS-së e ka depozituar emrin deputetja Blerina Gjylameti.

Grupimet e tjera nuk kanë depozituar emra.

Ju lutem, kush e do fjalën?

Po, zoti Ahmetaj.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë dhe tatimpagues,

Paketën fiskale, që po paraqesim sot në Kuvend, e kemi prezantuar dhe konsultuar në një raund të gjerë takimesh me sipërmarrësit dhe me grupet e interesit, është vazhdimi i politikave tona në mandatin e parë dhe të dytë. Kjo paketë ka në thelb plotësimin e konturit lehtësues për sipërmarrjen e vogël, si dhe mbështetjen e mëtejshme të sektorëve të bujqësisë dhe të turizmit. Pra, është vazhdimësi e natyrshme e filozofisë sonë qeverisëse dhe programit që ne kemi miratuar, duke lehtësuar ngarkesën për bizneset, si dhe duke stimuluar dy nga sektorët më prioritarë të ekonomisë.

Ku konsistojnë konkretisht, masat që propozohen? Unë do të bëj një përmbledhje të masave dhe lehtësive, më pas, në diskutimin nën për nen, jam i bindur se edhe deputetët, por edhe qytetarët do të kenë mundësi të marrin më shumë informacion. Sigurisht, Komisioni i Ekonomisë është mirinformuar deri në detaje gjatë debateve dhe diskutimeve që kemi zhvilluar në komision.

Siç e theksova, pas një turi të gjatë takimesh me sipërmarrësit në të gjithë vendin, pas masave të ndërmarra, në kuadër të betejës së antiinformalitetit, dhe si rrjedhojë e një premtimi të bërë nga Kryeministrit Rama, direkt pas miratimit të paketës fiskale në fund të vitit 2017, ne tashmë po bëjmë realitet lehtësimet konkrete për biznesin e vogël. Këtë gjë e kemi theksuar edhe kur ulëm prapen e deklarimit të TVSH-së. Këtu dua të ndalem një sekondë dhe të bëj një ballafaqim me grupin e munguar të opozitës, por në sy të qytetarëve. A e mbani mend, të dashur qytetarë, kur opozita thoshte: “Nëse ulet prapen i TVSH-së, do të rriten çmimet”? Si është sot e vërteta? E vërteta është se për të gjitha njësitë, që preken nga ulja e prapen të TVSH-së, është bërë një sondazh i drejtpërdrejtë nga INSTAT-i dhe jo nga qeveria. Rezultatet janë në dy drejtime:

E para, është inflacioni, që për muajt prill-maj rezulton të jetë në nivelin 2%, sa ka qenë në vazhdimësi e gati 5 vjetëve, 1,8%; 2,1%; 1,8%; 1,9%; 2,1%. Pra, nuk ka asnjë ndryshim. Brenda të njëjtit indeks, kemi parë indeksin e mallrave që tregtohen nga njësitë e prekura nga ulja e prapen, dhe ka ulje çmimesh për shumë produkte.

Kjo do të thotë se pretendimi i opozitës nuk është i vërtetë. Konkluzioni është se opozita jo vetëm që nuk përfaqësoi qytetarët, jo vetëm që nuk përfaqësoi biznesin e vogël, por nuk kontribuoi në konsolidimin financiar dhe fiskal të vendit. Ne po veprojmë në vazhden e një planimetrie lehtësimi fiskal, që shkon në përputhje me rritjen e sektorëve prioritarë të ekonomisë dhe me rritjen ekonomike, për të cilën unë do të flas pak më vonë. Tani po kaloj konkretisht te masat.

Së pari, tavanin nga 5-8 milionë lekë xhiro me tatimin e thjeshtësuar ka qenë dhe ngelet 5%. Ne po fusim brenda tatimfitimit një fashë të re nga 8-14 milionë lekë, pra tavanin e tatimfitimit shkon në 14 milionë, dhe do të jetë 3 herë më pak se sa ka qenë, pra nga 15% në 5%. Këtë e premtoi Kryeministri dhe e diskutoi me sipërmarrjen e vogël për 7 muaj rresht në të gjithë Shqipërinë. Bashkë me Kryeministrin, me qeverinë dhe të gjithë anëtarët e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, e kemi diskutuar në territor çështjen e biznesit të vogël. Frytet e diskutimit janë lehtësimi fiskal.

E dini çfarë ndodh, të dashur qytetarë dhe të nderuar deputetë? Me këto lëvizje, me këto lehtësime fiskale, që po bën qeveria sot dhe që po i aprovon ky parlament, 91% e sipërmarrjes në Republikën e Shqipërisë e ka tatimfitimin ose zero, ose 5%. Tani vijmë këtu, pas 5 vjetësh dhe gjithë ajo bolori antipolitike, parapolitike “u rritën taksat, u rritën taksat”, dolën boshe në fakt u ulën taksat. U fermentua çdo ditë e njëjta bolori “taksa, taksa”, por biznesi i vogël deri në 5 milionë lekë e ka zero lek tatimfitimin, zero!

U rrit pragu nga 8 në 14%. Sot 91% e sipërmarrjes e ka ose zero tatimfitimin, ose 5%, nga 15% që ishte. Po të ishte dikush këtu nga këta të munguarit, do të thoshte: “Ne e kishim 10%”. Po 5%, a është 2 herë më pak? Jo vetëm që është 2 herë më pak, por krahasimisht (fatkeqësisht ju nuk jeni këtu, por qytetarët na ndjekin), ju e rritët borxhin. Ne jo vetëm që kemi ulur taksat, por ne po ulim edhe borxhin. Ka 3 vjet rresht që qeveria, me operacionet e saj të përditshme, nuk krijon borxh të ri. Përkundrazi, kursen dhe trajton borxhin e trashëguar nga ju, të munguar.

Vazhdojmë më tej. Kombinuar me lehtësitë e aplikuara, siç e theksova, 91% e sipërmarrjes e ka ose zero, ose 5%. Në kuadër të mbështetjes së

sektorit të bujqësisë, qeveria ka sjellë uljen e normës së tatimfitimit korporativ nga 15% në 5% për fermerët e inkuorporuar në shoqatat e bashkëpunimit bujqësor.

Po ndalem një sekondë këtu, se kjo është shumë e rëndësishme dhe përbën themelin e promovimit të ekonomisë së shkallës në bujqësi. Kthehemi një hap prapa për të diskutuar me njëri-tjetrin se pse po e bëjmë këtë. Për çfarë e bëjmë këtë? Sepse jemi duke kuruar pikërisht atë problem që ka bujqësia. Çfarë problemi ka bujqësia? Problemi i bujqësisë është që i gjithë prodhimi është bazuar në ngastra të vogla toke, të copëtuara, ku teknologjia dhe bashkimi i faktorëve të punës, faktorëve të prodhimit, puna dhe kapitali, apo edhe teknologjia, nuk bëhen dot bashkë për shkak të këtij copëtimi. Atëherë, nëpërmjet instrumenteve fiskale që, në fakt, janë dy, një e bëmë para disa kohësh, me TVSH-në, një po e bëjmë tani, duke ulur tatimfitimin nga 15% në 5%, ne po promovojmë bashkimin e fermerëve, në mënyrë që politika e zhvillimit bujqësor dhe rural të ketë mundësi të injektohet, të përpunohet, të zbatohet dhe të zërë vend më lehtë.

Është ndryshe kur një politikë e zhvillimit bujqësor dhe rural vendoset në një platformë 10-hektarëshe, 20-hektarëshe, duke futur këtu edhe subvencionet, duke futur këtu edhe mbështetjen e buxhetit, duke futur këtu edhe instrumentin e garancisë, duke futur këtu edhe IPARD-in. Imagjinoni gjithë këto politika mbi një ngastër 1 dynym dhe mbi një fermë 10, 15, 20, 50 hektarë! Ky është qëllimi. Lehtësimi fiskal na çon në drejtim të konsolidimit të tokës, të konsolidimit të të gjithë faktorëve të prodhimit, të punës, të kapitalit, të teknologjisë, në mënyrë që të rritim produktivitetin e këtij sektori.

Ndryshimi tjetër i rëndësishëm konsiston në lehtësirat që paraqiten për agroturizmin. Prapë kthehemi këtu një hap mbrapa për të kuptuar jo thjesht këto lëvizje fiskale, por për të kuptuar në tërësi atë fill që kalon në të gjithë fabrikën e ndërtuar të modelit të ri ekonomik. Çfarë dua të them me këtë? Në vjeshtë të vitit të kaluar në këtë parlament ne aprovuam paketën për strukturat e akomodimit me 4 dhe 5 yje. Strukturat e akomodimit me 4 dhe 5 yje kanë investime, në potencë, të larta, që shkojnë, në rastin më fillestar, mbi 10 milionë euro dhe

pastaj kalojnë edhe në mundësinë e 50, 60 apo 100 milionë euro.

Paketa u godit nga opozita dhe goditja ishte: “Pse i ndihmoni ju këta oligarkët?” Pra, investimet e huaja u quajtkan tashmë oligarkë! Ne e bëmë këtë, sepse ishim të bindur se kishte ardhur koha që oferta jonë turistike të ishte konkurruese në krahasim me rajonin dhe jo vetëm. Madje atë ditë Kryeministri ka thënë se shumë shpejt do të avancojmë një mbështetje fiskale për agroturizmin, që është ana tjetër e turizmit, ku afron jo thjesht ujin, jo thjesht detin, jo thjesht diellin, por kalon në nivele të tjera, ka është ushqimi bio, janë aktivitetet sportive. Këto krijojnë mundësinë që të gjenerojnë zhvillim ekonomik dhe punësim në zonat rurale. Paketa edhe këtu është e konsoliduar.

Ka tri elemente shumë të rëndësishme. E para, dhe mbi të gjitha, ofron ulje të tatimitit nga 15% në 5 % për të gjitha njësitë e agroturizmit, që do të certifikohen në bazë të një vendimi specifik qeverie që, për transparencë është vendimi nr. 22, i shkurtit të vitit 2018 “Për certifikimin e njësisve të agroturizmit”. Pra, tatimitimi do të zbresë nga 15% në 5 %, tri herë më pak.

Boloria e fermentuar e taksave sot është e çmontuar njëherë e mirë përpara syve të opinionit publik. Kjo qeveri, kjo maxhorancë ka ulur taksat, ka lehtësuar ngarkesën fiskale për 97% të qytetarëve dhe sot del e thotë, me statistikë, “91% e sipërmarrjes e ka ngarkesën fiskale të ulur, pra tatimitimin nga 15% në zero dhe një pjesë e saj nga 15% në 5%”. Përveç kësaj, ulim TVSH-në për akomodimin dhe për ushqimin për agroturizmin nga 20% në 6 %.

Patjetër që ka pasur debate edhe për pijet, por unë, si ministër Financash, por edhe si anëtar i kësaj maxhorance, kam argumentuar që për shumë arsye, për shkak të aktivitetit dhe sistemit poroz të agroturizmit, është e pamundur që të mbahet kontrolli dhe balanca. Kështu që kemi mbetur vetëm në nivelin 6% të akomodimit dhe të ushqimit, për t'i dhënë një mbështetje shumë të rëndësishme edhe këtij segmenti të sektorit të shërbimeve dhe të nënsektorit të turizmit. Ndërkohë ato biznese që do të kenë rishitas investim në agroturizëm, do ta kenë taksën e infrastrukturës zero. Këtu jemi duke folur për një paketë shumë të rëndësishme me lehtësi fiskale që shkojnë drejtpërsëdrejti te biznesi i

vogël. E thamë do të mbështesim biznesin e vogël dhe atë po bëjmë. Thamë se do të ulim pragun e TVSH-së për të kontrolluar të madhin dhe po e bëjmë. Thamë se do të lehtësojmë agroturizmin, po e bëjmë sot. Thamë se do të mbështesim bujqësinë, po e bëjmë sot, edhe nga ana fiskale, edhe nga ana e mbështetjes buxhetore, edhe nga ana e ndihmës apo e negociatës dilegjente që lidhet me IPARD-in, programit për mbështetjen e bujqësisë.

Sot është momenti t'i kthehemi situatës ekonomike dhe ta ndajmë me qytetarët. Kemi diskutimin: A është bërë mjaft? A është situata rozë? A është ky vend i pasur? Jo, situata nuk është rozë, por situata është shumë më mirë se çfarë ka qenë.

Më në fund ekonomia shqiptare është futur në normalitet rritjeje, rritet me 4,5%. Ka qindra dhe mijëra qytetarë që me të drejtë mund të dalin dhe të thonë: “Po, mirë, u rrit 4,5%, po ne ku jemi?”. Po, patjetër që ka shumë për të bërë. Hajde t'u kthehemi numrave! Hajde t'u kthehemi jetëve të njerëzve! Hajde t'u kthehemi zemrave dhe mendjeve!

Më 1 janar të 2013-ës kanë qenë rreth 430 mijë të punësuar, sot janë 673 mijë të punësuar. Teknikisht duhet t'jua them që jam duke iu referuar E-Sig 27, borderosë së tatimeve që deklarojnë sipërmarrjet vetë, për hir të së vërtetës dhe të transparencës. Janë gati 240 mijë mendje, zemra, qytetarë, fytyra, familjarë, kryefamiljarë që shkojnë në punë më shumë se më 1 janar të 2013-ës. Legjitimisht dhe në të drejtën e tyre çdo qytetar duhet të dalë dhe të më thotë: “Një sekondë, Ministër, çfarë je duke thënë? Kjo është situatë rozë.” Jo! Mik i shtrenjtë, i dashur, që je ende pa punë, nuk është situatë rozë, por mos harro që kemi 240 mijë zemra, mendje, fytyra, familjarë e kryefamiljarë, që shkojnë në punë sot, më shumë sesa në 2013-ën.

A kemi halle? Pa fund ka halle Shqipëria, sepse vend i varfër është akoma, por është shumë herë më mirë se sa ka qenë në 2013-ën. Kur na dëgjoni këtu në debat dhe nganjëherë me të drejtën tuaj na përqeshni, nuk diskutohet se kemi arritur Gjermaninë dhe jemi vendi i dytë, ia kemi marrë edhe Holandës, nuk është ky diskutimi. Diskutimi këtu është fare i thjeshtë: e shpëtuam Shqipërinë nga humnera dhe e kemi

futur në normalitet, në rritje ekonomike, por kemi dhe shumë, shumë punë për të bërë.

Kjo paketë është një nga mendimet tona. Nëse doni të mos e quajmë paketë fiskale, le ta quajmë paketë solidariteti, sepse së bashku kemi shkuar te qeliza e ekonomisë, kemi futur syrin, mendjen te qeliza e ekonomisë, për ta ngacmuar pulsën e ekonomisë pozitivisht, tek ajo qelizë e vogël, tek ai fermeri, tek ai sipërmarrësi i vogël që shet përditë, që prodhon përditë, që krijon përditë, që afron shërbime përditë, tek ai i vogli, për ta ndezur akoma më shumë atë qelizë. Aty, tek ai fermeri në fshatin më të largët, duke i treguar që sot është mirë që ti të bashkohesh me fermerin tjetër që ke në krah, për të bërë një ekonomi më të mirë, për të pasur produktivitet dhe për të prodhuar më shumë.

Miq të dashur, e keni parë se çfarë ka ndodhur me eksportet? Sot po rritemi me dy numra në eksporte: 18.4 %. Patjetër dikush mund të thotë: “Çfarë je duke thënë, Ministër?!”. Por më besoni, nuk ka gëzim më të madh për një trupë që qeveris dhe që drejton Shqipërinë si kjo maxhorancë, që t’u referohet këtyre shifrave duke thënë: “Ka njerëz që prodhojnë dhe eksportojnë”. Deri dje nuk kishin asnjë mundësi. Ka njerëz që sot nuk kanë treg vetëm Tiranën, por kanë treg Italinë, Gjermaninë, Austrinë, Greqinë, Serbinë.

Por për çfarë jemi votuar? Nuk besoj se thamë ditën që u votuam se do të bëjmë çudira. Jo! Ne jemi njerëz normalë, do ta kthejmë këtë vend në shina normale dhe këtë po bëjmë, të tjerat i bën biznesi.

Çfarë bëmë ne me sipërmarrjen? I hoqëm duart që këta të munguarit ia kishin futur në fyt. Këtë bëmë ne. Ne bëmë gjënë më të thjeshtë që bën një maxhorancë. Këta këtu që mungojnë, i kishin futur duart në fyt sipërmarrjes. Ne e çliruam atë, do të vazhdojmë ta çlirojmë, sepse ka ende shumë punë për të bërë. Ka ende shtrëngesa të paarsyeshme në terrenin ekonomik. Këtu e ftoj sipërmarrjen që të na ndihmojë, sepse jemi ende në një proces konsultimi për paketën fiskale të vjeshtës, të na thotë se ku i kanë mbetur ende gishtat e këtyre në fyt, që t’ia heqim, ta çlirojmë komplet sipërmarrjen që të realizojmë atë ëndërr që kemi, t’i japim Shqipërisë rritje ekonomike mbi 5 %, që të përfitojë çdo qytetar, nga Kukësi, nga Tropoja, nga Saranda, nga Korça, nga Gjirokastra, nga

Vlora, nga Tirana, nga Fieri, nga Lezha, nga Dibra, gjithandej.

Ky është qëllimi që ne sjellim një paketë fiskale, e cila është baras me një paketë solidariteti, ku syri, mendja dhe zemra e një maxhorance shkon te qeliza më e vogël, më bazike e ekonomisë, te zemra, mendja, sytë, dora e fermerit; te zemra, mendja, sytë e sipërmarrjes së vogël, te zemra, mendja e sytë e atyre që bëjnë agroturizëm, që bëjnë biznes në zona rurale në favor të familjes së tyre, në favor të rajonit të tyre dhe në favor të zhvillimit ekonomik.

Unë ju ftoj që jo vetëm ta mbështesim, kjo nuk diskutohet, por të propagandojmë dhe të ndihmojmë që çdo biznesi i vogël, çdo sipërmarrje shqiptare ta ketë të qartë se çfarë sjell kjo paketë, që nuk është paketë fiskale, është paketë solidariteti me sipërmarrjen e vogël për ta ndihmuar të zhvillohet në favor të familjeve të tyre, të ekonomisë dhe të Shqipërisë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Fjala është për zotin Bushati.

Ervin Bushati – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Sot maxhoranca ndërmer një zinxhir masash për të ndihmuar mbi 10 mijë biznese shqiptare, si dhe 2 sektorët bazë të ekonomisë shqiptare. Këto masa nuk ndërmerren thjesht për të mbajtur një premtim elektoral, sepse nuk jemi në kohë fushate elektorale, po në mes të një mandati, por ndërmerren sepse mendojmë se mund të ecim përpara me masa fiskale, të cilat mbështeten në një administratë që sot funksionon shumë më mirë, në një situatë fiskale të konsoliduar dhe pa borxhe, ku mund të propozojmë një ndërmarrje të tërë për të formalizuar ekonominë dhe për të mbështetur biznesin e vogël, sepse sot i kemi mundësitë për ta bërë këtë gjë. Kjo që po bëjmë nuk ka të bëjë as me fushatën elektorale, as me synimin për të bërë diçka, që nuk është në realitetin ekonomik apo për të ndryshuar, por sepse besojmë që sot është momenti për të ndërhyrë.

Sinqerisht, më vjen keq që opozita nuk është e pranishme në një moment kaq të rëndësishëm, e cila, po të ishte këtu, jam i sigurt se do të votonte, deputetët e Partisë Demokratike do t’i votonin këto ndryshime. Por lidhshipi i Partisë Demokratike ndoshta për këtë

arsye nuk është sot në sallë, sepse nuk mund të votojë kundër këtyre ndryshimeve.

Në radhë të parë, mbi 10800 biznese do të përfitojnë nga ulja e tatimfitimit, që shkon nga 15% në 5%. Kemi kaq kohë që diskutojmë për një çështje shumë të rëndësishme, që ka të bëjë me formalizimin e ekonomisë. Kur ne flisim për formalizimin e ekonomisë, për të nxjerrë në dritën e diellit të gjitha bizneset, që secili të paguante atë që i detyrohej shtetit, që secili të konkurronte në mënyrë të ndershme, opozita thoshte: “Ne duam të godasim të gjithë biznesin, të dëmtojmë qytetarët dhe punësimin e tyre”. Ja pra, sot kjo maxhorancë harmonizon masat, që të kemi një formalizim të ekonomisë, si dhe një rritje të saj. Ekonomia shqiptare sot ka një ritëm të kënaqshëm dhe një trend pozitiv rritjeje prej 4,5%. Masat që po ndërmarrim do ta mundësojnë biznesin të zhvillohet më shumë, të ketë më shumë para për të investuar, si dhe të punësojë më shumë qytetarë. Këto do të rritin investimet, punësimin dhe zhvillimin ekonomik.

Gjithashtu, vëmendjen dhe mbështetjen tonë e kemi pasur në dy motorë të rëndësishëm, që mendojmë se mund të sjellin shumë për ekonominë shqiptare, e cila do të ketë një të ardhme të suksesshme, duke harmonizuar dhe duke kombinuar turizmin me biznesin agrar.

Mendoj se masat që marrim sot e çojnë vëmendjen pikërisht mbi një kapital motor, ende të pashfrytëzuar plotësisht, siç është turizmi. Turizmi shqiptar po tregon përditë e më shumë kapacitetin e tij të plotë se si mund ta çojë ekonominë shqiptare nga një nivel mbijetese në një nivel të kënaqshëm të rritjes ekonomike, punësimit, zhvillimit dhe investimeve të mëdha. Duke bërë këto investime sot, ne e kthejmë vëmendjen tek turizmi dhe te biznesi agrar, si dy hallka që duhet të lidhen dhe të punojnë bashkë për të përmirësuar ekonominë shqiptare, për të rritur punësimin dhe investimet.

Duhet të kemi parasysh që potenciali turistik i Shqipërisë nuk duhet të limitohet vetëm në 3 muajt e verës. Ata që konsumojnë gjatë gjithë vitit në ekonominë shqiptare, në turizmin shqiptar janë qytetarët shqiptarë. Të gjithë e dimë që qytetarët shqiptarë gjatë 12 muajve, në fundjavë, në ditët e festave apo të gëzimeve familjare dalin dhe janë më pranë një turizmi agrar, të cilin ne duam ta kemi në funksion gjatë 12 muajve për 2 arsye.

Në radhë të parë, për të pasur vazhdimësi dhe zgjatje të sezonit turistik, por edhe për të mbajtur në mënyrë konstante një kapacitet njerëzor, që këto biznese të funksionojnë gjatë gjithë vitit dhe të mos ndodhemi para situatës kur në 3 muajt e verës bizneset e turizmit të fillojnë dhe të ndihen në ngërç, sepse nuk përballojnë dot volumin e shtuar të punës apo të turistëve, nëse arrijmë të harmonizojmë dhe të kemi një lloj biznesi turistik që funksionon në 12 muaj, qoftë edhe nëpërmjet agroturizmit, ne do të kemi mundësi ta mbajmë gjallë këtë industri, që kapacitetet njerëzore të punojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe hotelet, restorantet, klubet të mos hapen vetëm 3 muajt e verës dhe të kalojnë në një fazë ringritjeje të dhimbshme, në një muaj, pastaj mezi të përballojnë kapacitetet në dy muajt e tjerë, por të funksionojnë gjatë gjithë vitit dhe qytetarët të punojnë gjatë gjithë vitit. Kështu do të jenë më të aftë dhe më të përgatitur për të punuar në muajt e tjerë.

Pika tjetër dhe më e rëndësishmja është formalizimi i ekonomisë, i cili stimulohet me ndryshimet që po sjellim sot. Paketa që paraqesim, më shumë se 12 masa, në fakt, e stimulon biznesin, e bën shumë më të thjeshtë, shumë më logjike dhe favorizuese daljen në dritë të diellit të bizneseve, të cilat shpeshherë mendojnë se mund të kenë më shumë përfitime, duke bërë evazion fiskal, duke iu shmangur tatimit, sigurimeve shoqërore, duke mos deklaruar gjithçka në shtet. Ulja kaq shumë e tatimfitimit, 5% tatimfitim për 90% të bizneseve në Shqipëri, nuk është diçka që mund t'i penalizojë ato. Ato, kështu jo vetëm formalizohen, por e kanë shumë më të thjeshtë, janë shumë më të gatshëm për të dalë, për të konkurruar dhe për t'u futur te bizneset e mëdha. Duke pasur një prag të tillë, një shkallë të tillë normimi, tatimi, 5%, ata nesër janë shumë më të motivuar që ta deklarojnë një biznes, ta hapin një të tillë, ta formalizojnë atë, pse jo të mendojnë të investojnë dhe të kenë plane të sakta biznesi për të kaluar në fazën tjetër, që është biznesi i madh.

Shpresoj që të gjitha këto masa të mos krijojnë një efekt bllokues në ekonominë shqiptare, por të bëjnë të kundërtën, të incentivojnë, të shtyjnë bizneset që të kalojnë në nivelet e zhvillimit, sepse është normale që çdo biznes të aspirojë për të pasur një volum sa më të

madh, e të mos mbetet te niveli 14 milionë lekë të rinj xhiro.

Duhet të kuptojmë se është njerëzore si te qytetarët, si te ata që investojnë me kapitale, si te bizneset, që të kërkojnë të rriten sa më shumë, të kenë sa më shumë volum tregtie, investimesh dhe biznesi.

Me këto masa që ne ndërmarrim sot, që kanë të bëjnë me biznesin agrar, që kanë të bëjnë me turizmin, që kanë të bëjnë me bizneset e vogla, patjetër që i jepet një impuls i ri shtesë ekonomisë shqiptare, sepse ne besojmë se duke mbështetur biznesin, duke mbështetur punësimin, duke mbështetur investimet, kthejmë në potencial pozitiv gjithë kapitalin e fjetur që është sot në Shqipëri. Ka shumë biznese shqiptare, ka shuam firma shqiptare, të cilat kanë kursime, i kanë në bankat shqiptare, e me këtë rast ne përfitojmë t'i ftojme të investojnë në Shqipëri, sidomos në këto dy biznese, të cilat incentivohen sot në mënyrë specifike, siç është biznesi agrar dhe biznesi i turizmit.

Në këtë mënyrë, me këto masa që kemi marrë, në fakt kemi krijuar edhe mundësinë që, shumë nga këto biznese, të cilat janë thjesht turistike, nesër mund të bëhen edhe biznese agrare; do të fillojnë të kombinohen. Pra, bizneset turistike, ato që janë më të afta në treg, sepse kanë më shumë kapitale, sepse kanë më shumë potencial, sepse kuptohet, edhe sistemet e menaxhimit i kanë më të mira se bizneset agrare, nesër këto biznese turistike do ta kenë shumë më të lehtë të kombinohen e të orientohen edhe ndaj biznesit agrar. Kjo na plotëson edhe një hallkë shumë të rëndësishme, që ka të bëjë me kapacitetet njerëzore, me plane biznesi më të strukturuar, më të menduara, më të menaxhuara, sepse bizneset turistike i kanë mundësitë, i kanë kapacitetet financiare, i kanë edhe kapacitetet njerëzore të ndihmojnë, e pse jo, edhe të bëjnë kalimin e butë drejt biznesit agrar.

Mendojmë se kjo do të jetë një pikë kthese në ekonominë shqiptare. Dua t'i them biznesit shqiptar, qytetarëve shqiptarë, se biznesi dhe zhvillimi ekonomik i Shqipërisë është primar për këtë maxhorancë e për këtë qeveri.

Më vjen keq që opozita, me gjithë zhurmën e zallamahinë që bëri para se të merrej ftesa për në Bashkimin Europian, para se të miratohen këto projektligje shumë të rëndësishme për biznesin, sot që miratojmë një paketë masash, një

zinxhir masash mbështetëse shumë të rëndësime për ekonominë shqiptare, e ka lënë sallën bosh.

Kjo opozitë, që ngelet *part time*, pra që punon vetëm *part time*, proteston *part time*, bën namin deri në dymbëdhjetë të natës në një ditë të caktuar, ndërsa gjashtë ditët e tjera të javës nuk vjen në komisione, kjo opozitë *part time* nuk është se përkujdeset për biznesin shqiptar, nuk është se ka ndër mend ekonominë shqiptare, nuk është se ka ndër mend punësimin e qytetarëve shqiptarë. Ajo ka ndër mend vetëm ardhjen në pushtet dhe kujdeset vetëm për karrigen e vet, prandaj, kjo opozitë *part time* nuk përpiqet, nuk vjen të votojë dhe nuk miraton një sërë masash që mbështesin ekonominë shqiptare.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Bushati!
Fjala për deputeten Evis Kushi.

Evis Kushi – I nderuar Kryetar i Kuvendit!
Të nderuar kolegë,

Javën e kaluar shpresova që, më në fund, parlamenti po i rikthehet normalitetit, pas disa muajsh që opozita e bllokonte foltoren këtu, duke mos na lejuar që ne të ushtronim të drejtën a detyrimin kryesor që kemi ndaj qytetarëve që na kanë votuar. Do të kisha preferuar që ai normalitet të ishte kthyer që para disa javëve, kur votuam rezolutën për hapjen e negociatave, për vendimin e Komisionit Europian për hapjen e negociatave me Shqipërinë. Ai do të kishte qenë një rast shumë i mirë, përmes të cilit ne, të gjithë deputetët, qofshim të maxhorancës, qofshim të opozitës, sot të kishim shprehur qëndrimin tonë të përbashkët, të ishim shprehur që jemi të gjithë të bashkuar kur është fjala për integritimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Fatkeqësisht, kjo nuk ndodhi, por megjithatë edhe paketa që do të votojmë sot ka një rëndësi mjaft të veçantë, pasi sjell lehtësim të drejtpërdrejtë për sipërmarrjen në disa sektorë, në mënyrë të veçantë për bujqësinë dhe agroturizmin.

Paketa ofron masa lehtësuese në tre drejtime kryesore: tatimin mbi të ardhurat, tatimin mbi vlerën e shtuar, si dhe taksat vendore. Më lejoni që edhe këtu të shpreh keqardhjen që paketa nuk mori vëmendjen e duhur gjatë shqyrtimit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, sepse për tri ditë rresht opozita e bllokoi zhvillimin normal të diskutimeve në komision. Pra, opozita jo vetëm

që nuk dha asnjë kontribut, asnjë sugjerim, asnjë mendim, asnjë ide, madje as edhe një kritikë apo rezervë, por nuk lejoi as që deputetët e maxhorancës të shprehnin mendimet e tyre, të bënin pyetje, diskutime, propozime e kështu me radhë.

Vetëm në mbledhjen e fundit të komisionit, që do të thotë të premten e kaluar, kur opozita nuk erdhi fare në komision, ne më në fund arritëm të kishim një diskutim konstruktiv, të bënim pyetjet, të merrnim përgjigjet e duhura, madje të bënim edhe propozime konkrete, edhe ndryshime, edhe përmirësime konkrete në projektligjet e paketës fiskale.

Edhe sot shpreh keqardhjen që opozita përsëri e bojkoton seancën, duke mos marrë pjesë në diskutimin dhe votimin e një pakete fiskale që, e përsëris edhe një herë, lehtëson në mënyrë të drejtpërdrejt sipërmarrjen në disa sektorë prioritarë të ekonomisë sonë.

Ndërkohë, siç e theksova pak më lart e ku dua të ndalem në mënyrë të veçantë, kjo paketë ofron shkallëzimin e normës së tatimit mbi fitimin, që do të thotë se për të gjitha bizneset me të ardhura deri në 14 milionë lekë, normën e tatimit mbi fitimin do të jetë 5 %.

Me këtë ndryshim ne realizojmë mbështetjen më të madhe që i është dhënë biznesit ndër vite, sepse arrijmë që 91 % e bizneseve në të gjithë Shqipërinë ta ketë tatimin 0% apo 5 %.

Së dyti, paketa ofron jo vetëm lehtësim fiskal, por edhe ristrukturim të sektorëve, siç është për shembull bujqësia, duke i nxitur fermerët të përfshihen në shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor nëpërmjet reduktimit të normës së tatim-fitimit kooperativ nga 15 % në 5 %.

Por, siç e theksova më lart, dua të ndalem pak më gjatë tani, në mënyrë të veçantë paketa krijon lehtësira fiskale dhe nxit zhvillimin e agroturizmit, i cili vijon të jetë prioritet ekonomik, i reflektuar edhe në programin e qeverisë, edhe në strategjinë ndërsektoriale për zhvillimin rural e bujqësor 2014 – 2020, por edhe në strategjinë për zhvillimin e zonave rurale 2018 – 2020.

Në mënyrë specifike, për të gjitha bizneset që janë licencuar dhe operojnë si agroturizëm, do të reduktohet norma e tatim-fitimit nga 15 % në 5 %. Po ashtu, të gjitha këto struktura do të

përfshihen nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Një ndryshim shumë i rëndësishëm është reduktimi i tatimit mbi vlerën e shtuar, pra i TVSH-së, nga 20 %, që është norma standarde, në 6 % për furnizimin e shërbimit të akomodimit e të restorantit brenda strukturave të agroturizmit, por duke përfshirë këtu furnizimin me pije. Në fakt, në këtë pikë, duke e vlerësuar edhe qëndrimin e ministrit, edhe argumentet që ai solli, unë kam një sugjerim, të cilin, së bashku me kolegun Braçe, do ta paraqesim në formën e një amendamenti në ligjin “Për disa ndryshime për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

Me qëllim stimulimin e plotë të aktivitetit të njësive pritëse në agroturizëm dhe me qëllim unifikimin e paketës fiskale me hotelet me katër e pesë yje, ne sugjerojmë që reduktimi i tatimit mbi vlerën e shtuar të aplikohet jo vetëm për shërbimin e akomodimit e të restorantit, por të aplikohet edhe në shërbimin e pijeve, qofshin këto alkoolike apo jo, të prodhuara e të ofruara brenda këtyre strukturave. Pra, e theksoj edhe një herë: vetëm për ato pije që prodhohen e ofrohen brenda këtyre strukturave. Ndërsa për pijet që prodhohen dhe shiten në struktura të tjera, në biznese të tjera apo në supermarkete, TVSH-ja të vazhdojë të aplikohet në normën 20 %.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, ju ftoj të gjithëve, ta votojmë paketën fiskale.

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Kushi!

Fjalën për ministrin e Turizmit, zotin Klosi.

Blendi Klosi – Të nderuar kolegë,

Paketa që po kalojmë sot është një paketë shumë e rëndësishme, një paketë e cila kërkon të ndihmojë jo një grup të përcaktuar qartë, jo një grup biznesmenësh që tashmë janë në fushën e agroturizmit, por kërkon të mbështesë mijëra e mijëra fermerë, të cilët do të duhet që, nëpërmjet kësaj pakete, të gjejnë një përthyerje të qartë të ndryshimeve ligjore në lehtësira për bizneset e tyre. Ai që ne duam të ngremë në Shqipëri, rrjeti i tërë i agroturizmit, i cili sot merr një mbështetje shumë të madhe edhe ligjore, është rrjeti i shumë e shumë fermerëve të vegjël apo të mesëm, të cilët mund të kenë, jo vetëm në 100 fshatra që ne kemi përcaktuar si fshatra pilotë, por kudo në Shqipëri, një pol zhvillimi ekonomik, që do të dëshmojë se munden të kenë biznes, munden të

kenë jetë, munden të kenë arsye për të qëndruar në zonat e tyre, në qoftë se fshati i tyre i traditës, fshati i tyre me histori apo fshati i tyre që prodhon histori apo trashëgimi kulturore, fshati i tyre që prodhon traditë në kulinari, fshati i tyre që ka traditë në agroturizëm, mund të shndërrohet në një pikë të vizitueshme nga turizmi shqiptar dhe nga turizmi i huaj; mund të shndërrohet në një arsye më shumë, që vetë ne, familjarët shqiptarë, të kemi mundësi që gjatë uikendeve të kalojmë nëpër këto pika agroturizmi, të ndihmojmë biznesin lokal dhe të futemi në një rrjet, i cili sot në Shqipëri ka pionierët e tij të parë.

Nuk po ndërtojmë një politikë, e cila vjen vetëm nga zyrat qeveritare, por që është në përputhje të plotë me zbatimin e asaj çfarë ne kemi bërë gjatë gjithë këtyre kohëve; dëgjimit dhe analizimit të çdo kërkesë dhe shqetësimi të biznesit të fushës. Po, biznesi i agroturizmit na e ka kërkuar me forcë që, në qoftë se nuk ka një paketë si kjo e sotmja, që do të ndihmonte në zhvillimin e tyre, do ta kishin shumë të vështirë të funksiononin e të mbijetonin në një treg të paformuar siç duhet. Prandaj kjo paketë vjen në kuadër të të gjitha politikave që po ndërmarrim në Shqipëri, për ta shndërruar turizmin në një ekonomi, për ta shndërruar turizmin në një nga mundësitë më të arta ekonomike të zhvillimit të vendit.

Sot ne jemi në mes të sezonit turistik, një sezon i cili, si rrallëherë, ka filluar shumë kohë më parë, një sezon që është më se premtues, i mbushur me turistë të huaj, ardhur nga e gjithë bota.

Megjithatë, përsëri kemi probleme. Përsëri kemi shqetësime. Përsëri kemi momente, të cilat duhet të na bëjmë të reflektojmë të gjithë së bashku. Përsëri kemi probleme me të tria parimet bazë, mbi të cilat duam të zhvillojmë sigurinë e një turizmi cilësor, që kanë të bëjë me sigurinë në plazhe, që kanë të bëjnë me pastërtinë nëpër plazhe, që kanë të bëjnë me realizimin e mikpritjes në plazhet tona.

Për sa i përket sigurisë, kemi punuar shumë gjatë gjithë vitit, kemi punuar për të ndërtuar komitetet e ruajtjes së turizmit në të gjithë Shqipërinë, kemi bërë takime, dhe për herë të parë kemi ngritur pikat e sigurisë, të cilat kanë të bëjnë me sigurinë në plazhe, me ruajtësit e ujit, e

po ashtu me sigurinë që ka të bëjë me Ministrinë e Shëndetësisë, pra me ruajtjen e jetës.

Në të tria drejtimet kemi avancime të jashtëzakonshme, krahasuar me një vit më parë. Kemi përcaktuar qartë me bashkitë, se ku do të jenë vendet e mjeteve lundruese, dhe falë Zotit, kemi akoma një sistem i cili po monitoron, kështu që nuk kemi asnjë incident në plazhet tona për sa u përket mjeteve lundruese. Kemi një reduktim shumë të madh. Përsëri kemi ngjarje, për këtë jemi kokulur, dhe humbje jetësh në plazhet tona, por ama sistemi i ruajtjes së plazhit është ngritur pothuajse në të gjithë Shqipërinë, jo në kushtet që duhet, por ama po funksionon, dhe kemi disa jetë të shpëtuar në të gjithë plazhet tona vetëm nga sistemi i ruajtjes së plazheve. Në krahasim me vitin e kaluar, kemi një numër shumë të reduktuar të jetëve të humbura në plazhe, por përsëri një jetë e humbur na e rrëzon të gjithë atë çfarë themi. Duhet të jemi të gjithë së bashku atje, së bashku me pushtetin qendror, së bashku me pushtetin lokal, së bashku me vetë poseduesit e operatorëve turistikë, të cilët duhet të kuptojnë se kjo është një përpjekje, që duhet të vijë nga poshtë lart. Nuk mund të vëmë njerëz të shtetit për të ruajtur plazhet, duhet të jetë vetë biznesi, siç e përcakton edhe vendimi i Këshillit të Ministrave, që duhet ta promovojë dhe ta realizojë këtë siguri.

Për sa i përket sistemit shëndetësor, kemi ngritur prej vitesh, por këtë vit i kemi në perfeksion, qendrat e ndihmës së parë; kemi ndërtuar 26 pika ambulatorie në të gjithë sistemin e plazheve, dhe për herë të parë kemi 18 qendra ambulance, të cilat përgjigjen në të gjithë zonën bregdetare, në harkun kohor të 10 minutave. Pra, janë këto përpjekje, të cilat na bëjnë të mendojmë se sezoni do të vazhdojë të jetë i suksesshëm, me numër të rritur turistësh. Por sa më shumë rritet numri i turistëve, aq më shumë shtohet përgjegjësia jonë për të pasur mundësi që të kemi një sezon të diversifikuar.

Paketa që sjellim sot është kryekëput një paketë, e cila kërkon diversifikim të ofertës, por edhe forcimin e arsyeve pse duhet të bëjmë turizëm në Shqipëri. Sot po miratojmë paketën e agroturizmit, e cila kërkon 4 gjëra: zhvillimin ekonomik në zonat me mundësi të kufizuara agroturistike: krijimin e vendeve të reja të punës; zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe, pa dyshim, ajo që është më kryesorja, rritjen e të

ardhurave apo me fjalë të tjera, rritjen e mirëqenies për këto struktura akomoduese.

Çfarë kuptojmë me agroturizëm? Agroturizmi është ajo veprimtari pritëse, që zhvillohet në një fermë apo në njësi agrokulturore, për të tërhequr vizitorë, shpesh duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtarinë bujqësore apo në veprimtari të tjera ndihmëse, që zhvillohen në atë mjedis bujqësor. Agroturizmi do të zhvillohet në zonat rurale, si veprimtari që ka një potencial të lartë zhvillimi ekonomik dhe ndikon drejtpërsëdrejti në familjet e këtyre zonave.

Subjektet që do të investojnë në agroturizëm duhet t'u nënshtrohen kritereve specifike për t'u certifikuar si strukturë akomoduese agroturistike, të cilat do të ndihmojnë për të pasur një rrjet të certifikuar subjektsh që mund ta ofrojnë këtë shërbim, për të qenë të ndihmuar në hapat e tyre nga strukturat shtetërore.

Po i shfrytëzoj këto 3 minuta, që më mbeten nga koha ime, për të informuar dhe për të njoftuar opinionin publik, (këto kohë kemi bashkëpunuar edhe me Ministrinë e Bujqësisë, dhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe me Ministrinë e Kulturës, edhe brenda kuadrit të "100 fshatrave"), se çfarë do të thotë një strukturë agroturistike. Agroturizmi do të mbështesë turizmin e qëndrueshëm të zonave rurale nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së traditës dhe promovimit të produkteve tipike të zonës. Një subjekt që do të certifikohet si agroturizëm, duhet të plotësojë kryekëput disa parime, mbi të cilat ne kemi caktuar dhënien e certifikatës.

Agroturizmi, si veprimtari, mund të zhvillohet në fermat, që i plotësojnë këto kritere. Ferma bujqësore duhet të ketë të paktën 1 hektar tokë të mbjellë me kultura bujqësore ose minimalisht 0,5 hektar serra. Fermat blektorale duhet të mbarëshojnë minimalisht 10 krerë gjedhë apo 100 krerë dele, dhi apo 200 krerë shpendë. Te fermat blegtorale klasifikohen edhe stanet, fermat e peshkimit apo akuakultura. Agroturizmi duhet të zhvillohet në një njësi agrokulturore, që ka si aktivitet përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, të peshkimit dhe të akuakulturës, si, për shembull, pikat e përpunimit të vajit, të ullirit, fabrikat e përpunimit të verës, të rakisë, të frutave të

ndryshme apo gjithë këtë sistem në zonën bujqësore.

Subjektet që zhvillojnë veprimtari pritëse të klasifikuara, si agroturizëm, duhet të ofrojnë minimalisht njërën nga shërbimet e mëposhtme: akomodim, ushqim, pije, veprimtari argëtuese shlodhëse, të lidhura me fermën apo mjedisin përreth. Subjektet agroturistike, që ofrojnë akomodim, duhet të kenë të paktën nga 6 deri në 30 dhoma dhe jo më shumë se 30 dhoma, për të mos ta shndërruar atë në një hotel që prish strukturën e hoteleve të zonës.

Strukturat në të cilat do të ofrohet shërbimi i akomodimit, sipas klasifikimit të ligjit për turizmin, në fuqi, duhet të respektojnë kriteret urbanistike dhe kriteret e tjera në fuqi për ndërtimin e përcaktuar sipas planeve të zhvillimit të zonave vendore, po ashtu për të ruajtur edhe traditën e zhvillimit të kritereve ndërtuese në atë zonë.

Akomodimi mund të ofrohet edhe në formën e pushimit në ambiente ku vendosen çadra apo kampingje. Ofrimi i ushqimit dhe pijeve që bëhen brenda ambientit, duhet të jenë produkt i zonës, po ashtu ushqimet për të cilat ne lejojmë që të certifikohet një zonë, duhet të jetë nga 30% - 70% e produkteve që e ofron ajo njësi.

Pra, të nderuar kolegë, ne do të vazhdojmë t'i promovojmë këto kritere, pasi mendojmë se agroturizmi realisht mund të shndërrohet në një mekanizëm shumë të fortë zhvillimi jo vetëm i turizmit lokal, por edhe i njësive ekonomike për zhvillimin e më shumë mjeteve në zonën rurale.

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Klosi!

Fjalën e ka zoti Ilir Beqaj.

Të përgatitet Arben Pëllumbi.

Ilir Beqaj – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot qeveria propozon disa ndryshime në ligjet kryesore fiskale, të cilat vazhdojmë të njëjtën filozofi të filluar para 5 vjetëve dhe të përmirësuara me përpjekjet e konsolidimit vit pas viti. Me këto ligje ne prekim edhe atë çfarë ndodh në biznesin e madh dhe çfarë ndodh në biznesin e vogël, sigurisht, duke u dhënë përparësi disa sektorëve, të cilët jo vetëm që janë identifikuar si shtyllat e modelit të ri ekonomik, por edhe kanë pasur përmirësime të ndjeshme dhe të prekshme këto vite: kanë ndikuar në rritjen e përgjithshme ekonomike, kanë ndikuar

në përmirësimin e bilancit tregtar, për pasojë në përmirësimin e gjendjes së llogarisë korrente dhe këtu besoj se duhet parë pse kemi një situatë, ku monedha kombëtare është forcuar kundrejt euros.

Ka muaj që bëhen debate, ka pasur pretendime para një viti, në kohë fushate, që u financua nga para jo të pastra. Situata sot provon të kundërtën, sepse turizmi ka përmirësim të ndjeshëm jo vetëm në numër vizitorësh, jo vetëm në ditë qëndrimi, por, tashmë, është i reflektuar edhe në balancën e sektorit. Në qoftë se në vitin 2013 hyrjet dhe daljet ishin zero, sot balanca është tejet pozitive, aq sa vjet turizmi dha 1,7 miliardë euro vetëm nga vizitorët e huaj, ndërsa sivjet pritet të shkojë në 2 miliardë.

Me miratimin e sotëm të ndryshimit të ligjit për të ardhurat, duke filluar nga 1 janari, ne vazhdojmë ta konsolidojmë angazhimin e një taksimi të ndershem, duke taksuar shumë më pak shumicën dërrmuese jo vetëm të individëve, por tashmë edhe të bizneseve, sepse, pas këtij ndryshimi, me mbi 14 milionë lekë të rinj xhiro vjetore mbeten vetëm 9% e sipërmarrjeve në Shqipëri. Rreth 65 mijë biznese me të ardhura deri në 2 milionë e kanë zero taksën; edhe ato deri në 5 milionë përsëri e kanë zero; ishim deri në 8 milionë në vit me 5%, shkojmë në 14 milionë. Në qoftë se e mbani mend, para 5 vjetësh u thamë shqiptarëve se do ta përgjysmojmë, për shumicën e bëmë zero, ndërsa sot që flasim për bizneset që janë me xhiro nga 8-14 e ulim barrën fiskale me tri herë.

Ne duhet të ndjekim me vëmendje reflektimin e këtyre masave fiskale në uljen e kostove, për rrjedhojë edhe të çmimeve, në rritjen e konkurrencës dhe pa dyshim, të harmonizuara me përpjekjet që po bëhen, në infrastrukturën rrugore, në furnizimin me ujë të pijshëm, në furnizimin me energji elektrike, në trajtimin e ujërave të zeza dhe mbetjeve. Këto janë arsytet pse sot, praktikisht, Golemi po rikthehet dhe shfrytëzohet si një pasuri kombëtare. Pak besonin para 5 vjetësh se katastrofa e infrastrukturës në Golem do të rimëkëmbej. Atje sot kemi hotelet më të mira të vendit, që e kanë sezonin turistik 120-130 ditë. Pse? Po e përsëris, falë rrugëve, tani edhe rrugëve të brendshme, furnizimit më të mirë me energji elektrike, ujërave të zeza që pastrohen, furnizimit me ujë të pijshëm, sigurisht, sigurisë

dhe promovimit. Por çfarë sjellin të gjitha këto? Sjellin punësim. U angazhuam për 300 mijë vende pune para 5 vjetësh, nga të cilat gjysma në sektorin jorural. Ka arritur në 230 numri i të punësuarve, të cilët sjellin të ardhura për familjet, sjellin konsum. E kemi thënë, së pari, punësimi është edhe dinjitet. Kështu që edhe nëse momenti aktual kur bëjmë miratimin, nuk është momenti kur ka vëmendje më të madhe nga subjektet, unë besoj se strukturat fiskale e kanë të gjithë kohën e nevojshme, nga korriku deri në janar, për t'u përgatitur, për të informuar bizneset dhe për të bërë dhe projektet e tyre, me qëllim që nga 1 janari t'i japim një shtysë më të madhe kësaj fashe të sipërmarrjes, e cila do të nxitet edhe më shumë që të investojë dhe të punësojë.

Qeveria këtë vit ka si objektiv primar punësimin. Faktet tregojnë se javë pas javë, edhe me një rol shumë më aktiv të zyrave të punës, punësimi vazhdon të rritet, edhe pse, nga njëra anë, kemi përsëri kontradiktën: njerëz pa punë dhe biznese që nuk arrijnë të gjejnë fuqi punëtore, sipas specialitetit apo kualifikimit që kërkohet. Kjo duhet ta nxisë qeverinë, që, bashkë me lehtësirat fiskale dhe biznesin, të bëjë përpjekje për të përmirësuar edhe cilësinë e kërkesës së tregut të punës.

Kam një kërkesë të vogël për Ministrinë e Financave për paketën e ardhshme fiskale, që, në fakt, lidhet me ligjin për taksave vendore. Por në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese na ka ardhur një shqetësim, praktikisht nga Bashkia e Beratit, ku atje këshilli bashkiak ka miratuar tarifa të reja, jashtëzakonisht të larta, për ata që ofrojnë me kabull shërbimin e internetit, duke e bërë koston mujore 60-70 mijë lekë të vjetër në muaj, duke bërë kështu një barrierë për shtrirjen e internetit. Me drojën time se mund të shtrihet edhe në bashki të tjera, do t'i kërkoja Ministrisë së Financave të shikojë nëse ka nevojë për të përmirësuar legjislacionin, që në paketën e ardhshme fiskale, në nëntor, të sjellë ndryshimin ose të bëjë sqarimet nevojshme, të përdorë instrumentin e prefektit për të mos lejuar që këshillat bashkiakë të bëjnë devijime nga ligji i financave vendore, që më pas sjellin edhe kështu barrierash në vend.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Beqaj!

Fjalën e ka zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

E kërkoja me shumë kënaqësi fjalën në këtë seancë, në të cilën do të diskutojmë paketën fiskale, e cila vjen me disa ndryshime në tri ligje: për tatimet mbi të ardhurat, tatimin mbi vlerën e shtuar dhe taksat për pushtetin vendor. Në një kohë kur ekonomia jonë në këtë 6-mujor ka njohur një rritje të qenësishme dhe kur papunësia është në nivelin më të ulët historik të saj, sigurisht nuk kemi vend për euforizëm, por kemi vend për t'u gëzuar, pasi, sipas INSTAT-it, në 3-mujorin e parë kemi një rritje ekonomike prej 4,45% dhe rritje të konsumit real prej 3%, tregues këta, që premtojnë shumë për vijueshmërinë e këtij viti.

Çfarë synojnë në vetvete këto projektligje, në veçanti projektligji për tatimin mbi të ardhurat?

Qëllimet janë në disa plane dhe në disa fusha, por ajo që është shumë e rëndësishme të theksohet është fakti se propozohet vetëm ulje e barrës fiskale, me synim mbështetjen për zhvillim. I tillë është edhe ndryshimi i parë, sepse jo vetëm që drejtohet ndaj sektorit bujqësor, të cilin e kemi si prioritet zhvillimi, por është edhe shtysë reale e rritjes ekonomike. Ky nuk është thjesht një ndryshim, por synon të nxisë fermerët të përfshihen në shoqëri të bashkëpunimit bujqësor. Vetëm bashkimi i fermave të vogla në shoqëri më të mëdha mund të sjellë rritje të prodhimit dhe ulje të kostove. Për këtë arsye, në këtë projektligj propozohet ulja me 3 herë e tatimit mbi fitimin, nga 15% në 5%. Jam i bindur që ky ndryshim do të sjellë efektet e duhura. Dua të theksoj se jemi në një vit që eksportet tona bujqësore kanë njohur rritje të qenësishme.

Gjithashtu, në vazhden e mbështetjes që qeveria po i jep turizmit, pas asaj që dhamë për strukturat hoteliere akomoduese në përgjithësi, duke ua reduktuar TVSH-në në 6%, për ato me 4 e 5 yje në veçanti, mendojmë se burimi i madh zhvillimit dhe i punësimit mund të vijë edhe nga sektori i agroturizmit, i cili ka marrë zhvillim të madh në të gjitha vendet europiane dhe, për sa kohë ne i kemi të gjitha mundësitë sociale dhe natyrore, në mënyrë të padiskutuar do të njohë rritje edhe te ne.

Agroturizmi, edhe pse në vetvete është një iniciativë, që përgjithësisht është biznes i vogël ose i mesëm për vetë karakteristikat që ka, mund të shtrihet pothuajse në të gjithë vendin, duke sjellë një ndikim konkret në punësim dhe zhvillim në ato zona, aktualisht, të prapambetura ose të thella. Pra, për zhvillimin e turizmit në zonat rurale, i cili mund të sjellë rritje të prodhimit dhe të tregtimit të produkteve bujqësore lokale, propozohet ulje e tatimit të fitimit korporativ me 3 herë, nga 15 në 5%, për një periudhë 10-vjeçare për të gjitha ato struktura, që brenda 31 dhjetorit të vitit 2021 do të përfitojnë statusin “subjekt i certifikuar agroturizmi”.

Tashmë në legjislacionin për turizmin është parashikuar kategoria agroturizëm si pjesë e tij, siç e sqaroi edhe ministri i fushës. Gjithashtu, me vendim të Këshillit të Ministrave janë përcaktuar edhe kriteret për licencimin e tyre.

Nxjtja e këtij biznesi, i cili pritet të ofrojë akomodim, si dhe veprimtaritë e tjera të lidhura me fermat bujqësore, shoqërohen edhe në projektligjet, që do të paraqiten për diskutim dhe votim si pjesë e kësaj pakete fiskale dhe synojnë një mbështetje akoma më të madhe, duke e reduktuar TVSH-në në 6%, si dhe përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Një tjetër ndryshim në këtë projektligj, që dua ta theksoj, lehtëson ngarkesën fiskale për afërsisht 10800 tatimpagues, dhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, ku unë bëj pjesë, ka një kontribut jo të vogël, është ulja e tatimit për bizneset e konsideruara të mesme, të cilët deklarojnë të ardhura vjetore deri në 14 milionë lekë, edhe këtu parashikohet ulja e tatimit mbi fitimin me 3 herë, nga 15 në 5%. E thënë me fjalë të tjera dhe më të kuptueshme, rritim tavanin e aplikimit të taksimit prej 5%, nga 8 milionë, që është sot, në 14 milionë lekë. Ky veprim synon mbështetjen e bizneseve të vogla, të cilat deklarojnë të ardhura vjetore rreth 8 milionë lekë, vlerë që në vitet e fundit është rritur automatikisht si rezultat i rritjes së çmimeve dhe indeksimeve pa sjellë fitime reale për to, por, nga ana tjetër, ul barrën për bizneset e mesme, duke synuar të qetësojë dhe të rrisë transparencën e deklarimeve. Së bashku me ndryshimet e bëra në paketën e kaluar për përfshirjen në skemën e TVSH-së edhe të bizneseve me të ardhura nga 2 në 5 milionë lekë,

jemi të bindur se shkojmë në rrugën e duhur për një formalizim gjithnjë e në rritje të deklarimeve.

Një korrigjim me shumë vlerë bëhet në ndryshimin e skemës së tatimit të investitorit në ndërtim në marrëdhënie shkëmbimi me pronarët e truallit, sipas një kontrate shkëmbimi. Sot në të ardhurat e tatueshme të investitorit, llogariten edhe të ardhurat, të cilat i korrespondojnë pjesës së sipërfaqes së ndërtimit, që përfitojnë pronarët e truallit, duke e ngarkuar me një barrë fitimi, e cila nuk është faktike nga shitja dhe ia ka rritur në mënyrë fiktive të ardhurat investitorit. Edhe pse ky korrigjim, për mendimin tim, vjen me vonesë, gjithmonë vlen shprehja “Më mirë vonë se kurrë”. Ky ndryshim ka pasur nevojë edhe për disa masa, që tashme janë marrë, siç janë ngritja e kadastrës fiskale, që sigurisht ka qenë një ndërmarrje më vete, si dhe ndryshimi i udhëzimit të përbashkët nr. 9 midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Duke qenë i bindur se këto ndryshime sjellin dhe ndihmojnë vazhdimin e rritjes ekonomike, formalizimin e ekonomisë dhe rritjen e konsumit, ftoj kolegët e maxhorancës ta votojnë këtë projektligj.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Fjala e ka zonja Antoneta Dhima. Të nderoj Xhevit Bushaj.

Antoneta Dhima – I nderuar zoti Kryetar, Të nderuar kolegë,
Të dashur qytetarë,

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi dhe miratoi projektligjet për disa ndryshime në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar, ligjin për tatimin mbi të ardhurat, si dhe ligjin për sistemin e taksave vendore. Këto projektligje mbështesin sektorin e agroturizmit, i cili është një nga prioritetet e qeverisë shqiptare në këtë mandat të dytë qeverisës.

Agroturizmi është një sektor, që mbështet zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të zonave rurale nëpërmjet mbrojtjes së ambientit, ruajtjes së traditave dhe promovimit të produkteve tipike të zonës.

Me ndryshimet e miratuara, zhvillimi i agroturizmit në zonat rurale do të shoqërohet me nxitjen e prodhimit dhe tregtimit të produkteve

lokale të zonave të ndryshme të vendit. Kjo iniciativë e ndërmarrë nga ana e qeverisë do të synojë të nxitë krijimin dhe rritjen e bizneseve, të cilat priten të ofrojnë akomodim, ushqim, çlodhje, argëtim dhe veprimtari të tjera të lidhura me fermën ose njësinë agrokulturore.

Projektligji për tatimin mbi vlerën e shtuar parashikon aplikimin e normës së reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar prej 6%, nga 20%, që është norma standarde, për furnizimin e shërbimit të akomodimit, restorantit, me përjashtim të furnizimit të pijeve brenda strukturave që zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuara, si agroturizmi.

Projektligji për sistemin e taksave vendore ka si qëllim përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe investimeve në infrastrukturë të subjekteve që zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuara si agroturizëm. Ndërsa projektligji për tatimin mbi të ardhurat ka si qëllim reduktimin e normës së tatimit mbi fitimin për sektorin e agroturizmit, nga 15% në 5%.

Në kushtet ku ndodhet agroturizmi shqiptar e ka të vështirë të konkurrojë me nivelin dhe cilësinë, që aktualisht ofron agroturizmi në vendet e rajonit. Ofrimi i shërbimit të agroturizmit në nivele cilësore, me një infrastrukturë të mirë dhe bashkëkohore është i domosdoshëm, pasi këto do të bëjnë të mundur rritjen e numrit të turistëve.

Natyra e bukur shqiptare na ofron mundësi të mëdha, pothuajse në të gjithë territorin e vendit, sidomos në zonat malore. Krijimi i lehtësirave fiskale do të mundësonte zgjerimin edhe më gjerë të investimeve në këtë fushë dhe në zona të tilla, ku ka nevojë jo vetëm për punësimin, por edhe për zhvillimin ekonomik të këtyre rajoneve në funksion të agroturizmit, dhe jo vetëm.

Përpos përmirësimit të infrastrukturës agroturistike, apo përsosjes së imazhit dhe të prestigjit të vendit, këto investime do të kontribuojnë, gjithashtu, edhe në hapjen e vendeve të reja të punës direkte dhe indirekte; rritjen e turistëve e të vizitorëve me potencial të fuqisë blerëse, që do të vijnë në Shqipëri, si dhe rritjen e konsumit. Të gjitha këto ndërhyrje përkthehen në përfitime për komunitetin dhe të ardhura shtesë për shtetin në formën e taksave dhe tarifave.

Agroturizmi në vetvete nuk është gjë tjetër veçse veprimtari pritëse që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrokulturore, me qëllimin tërheqjen e vizitorëve, duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtaritë bujqësore ose në veprimtari të tjera ndihmëse, që zhvillohen në atë mjedis bujqësor.

Reduktimi i normës së tatimit mbi fitimin korporativ nga 15% në 5% do të sigurojë nxitjen e fermerëve, që përfshihen në shoqërinë e bashkëpunimit bujqësor dhe nxitjen e bizneseve, që janë të licencuara dhe operojnë në fushën e agroturizmit.

Për bizneset me të ardhura deri në 14 milionë lekë, norma e tatimit mbi fitimin propozohet 5% e fitimit para tatimit, ndërsa për bizneset me të ardhura mbi 14 milionë lekë norma e tatimit mbi fitimin të mbetet 15% e fitimit para tatimit.

Spektori i bujqësisë përbën një ndër sektorët bazë të ekonomisë shqiptare. Zhvillimi dhe modernizimi i tij do të ketë impakt edhe në sektorë të tjerë prioritarë për vendin, sikurse është industria e turizmit, e cila e ka të nevojshme bashkëpunimin me një sistem bujqësor, që është në gjendje të garantojë furnizimin me produkte bujqësore dhe blegtorale në sasi, në cilësi dhe në kohë.

Ndërkohë, një sektor bujqësor i kompozuar nga fermerë individualë me ngastra të vogla toke dhe prodhim minimal për treg nuk është në gjendje t'i plotësojë kërkesat e konsumatorëve dhe, për më tepër, ato të një industrie, siç është turizmi. Gjithashtu, është e vështirë që prodhuesit individualë të jenë faktorë të rëndësishëm për rritjen e eksporteve të produkteve bujqësore. Për këto arsye, është e domosdoshme që të rritet shkalla e kooperimit në bujqësi, një ndër format e së cilës janë shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor. Rritja e kooperimit të fermave dhe krijimi i këtyre shoqërive kërkon edhe stimuj nxitës. Në këtë kuptim, krahas masave të tjera nxitëse të sektorit bujqësor, sikurse janë subvencionimet, investimet në kullim, ujë, vaditje e të tjerë, është e arsyeshme që nxitjes së kooperimit dhe krijimit të njësive të mëdha prodhuese bujqësore t'i shërbejë edhe një normë tatimi mbi fitimin e reduktuar për këto shoqëri.

Reduktimi i normës së tatimit mbi fitimin për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor nga 15%

në 5% nuk do të shoqërohet me reduktim të të ardhurave në buxhetin e shtetit, pasi aktualisht numri i atyre që janë regjistruar është minimal (rreth 30 të tilla), ndërkohë që kontributi fiskal në buxhet ka qenë i papërfillshëm. Pritet që rritja e numrit të SHBB-ve dhe e volumit të punës së tyre do të çojë në rritjen e të ardhurave, rrjedhimisht edhe të kontributit fiskal.

Reduktimi i normës së tatimit mbi fitimin për sektorin e agroturizmit nga 15% në 5% nuk do të shoqërohet me reduktim të ardhurash në buxhet, pasi numri i njësive agroturistike është minimal dhe pjesa më e madhe e tyre janë të regjistruara si biznes i vogël.

Shqipëria është vend i potencialeve të mëdha. Krijimi i fermave biologjike në vendin tonë është një hap përpara drejt zhvillimit të agroturizmit. Në to vizitorët mund të ndjekin nga afër të gjitha ambientet e prodhimit në fermë dhe të konsumojnë, mes qetësisë dhe gjelbërimit, produktet e fermës. Mundësitë e shfrytëzimit të fermave janë të pafundme dhe nuk lidhen vetëm me prodhimin.

Ajo që dua të them është se hapësira gjeografike e Shqipërisë është e përshtatshme më së miri me mënyrën e zhvillimit të agroturizmit. Fakti që një vend i vogël, siç jemi ne, i cili shtrihet nga rëra e bregdetit Adriatik, peizazhet e bukura të Jonit, fusha e Ultësirës Perëndimore të Myzeqesë, kodrat e ëmbla anës të lumenjve Erzen dhe Mat, parqet kombëtare të shtrira në të gjithë vendin dhe malet e mrekullueshme në Veri dhe Jug të Shqipërisë janë mundësi vetëm për zhvillimin e agroturizmit. Duhet theksuar se Shqipëria nuk e ka të domosdoshëm rregullimin e peizazhit, pasi ai është i mrekullueshëm dhe i larmishëm.

Në kushtet kur këto projektligje janë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mbështesin agroturizmin, si një nga prioritetet e qeverisë shqiptare, për t'i dhënë hov zhvillimit ekonomik dhe të qëndrueshëm në zonat rurale, ju ftoj t'i miratojmë këto projektligje të paketës fiskale, sepse ulja e taksave mbështet sipërmarrjen, mbështet biznesin dhe do të mbështesë njësitë agroturistike.

Faleminderit!

(Drejtimitin e seancës e merr zonja Vasilika Hysi.)

Vasilika Hysi –Faleminderit, zonja Dhima!

Fjalën e ka Xhevit Bushaj. Të përgatitet deputeti Roland Xhelilaj.

Xhevit Bushaj – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Shoh me keqardhje veprimet e kolegëve të opozitës, që në çdo seancë qëllim kryesor nuk kanë diskutimin dhe mendimin konstruktiv për projektligjet që vijnë për diskutim dhe miratim në Kuvendin e Shqipërisë, por kanë përbaltjen e punës së qeverisë dhe krijimin e situatave të ndryshme për realizimin e qëllimeve politike, në shërbim të partisë së tyre. Harrojnë shpesh se parlamenti është i të gjithë shqiptarëve dhe është në funksion të tyre.

Ne, si përfaqësues të popullit, duhet ta shohim këtë sallë vetëm në interes të njerëzve, të cilët, me votën e tyre, na kanë besuar që këtu të jemi zëri, shqetësimi dhe forca e mendimit të tyre.

Unë, personalisht, nuk kam ndër mend t'i përgjigjem baltosjes suaj, kolegë deputetë të opozitës, as shpifjeve e sajësive tuaja për çdo problem dhe çështje që diskutojmë.

Shqiptarët, ata që na kanë votuar dhe që përditë ndjekin me interes të veçantë, presin nga ne seriozitet dhe përkushtim në zgjidhjen e problemeve dhe halleve që i shqetësojnë përditë.

Shpesh gjeni pretekste për të bllokuar punimet normale dhe funksionimin normal të seancave plenare, të komisioneve, por edhe funksionimin në tërësi të parlamentit. Në çdo seancë qëllim të caktuar politik keni realizimin e skenarëve të ndryshëm dhe në vend të një mendimi të qartë, profesional dhe konstruktiv, ju zgjidhni të silleni në të njëjtën mënyrë dhe në çdo moment të transmetoni të njëjtën kasetë të incizuar në selinë e partisë suaj. Të njëjtën gjë po bëni edhe sot, duke e bojkotuar këtë seancë shumë të rëndësishme, që flet për paketën fiskale dhe për pjesën më të madhe të qytetarëve shqiptarë.

Projektligji, që po diskutojmë sot “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”; nr. 3632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”) është diskutuar gjerësisht në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, si dhe është i

mbështetur në nenet 78, 83, pika 1 të Rregullores dhe nenit 155 të Kushtetutës.

Projektligjet kanë për qëllim të realizojnë nxitjen e fermerëve të përfshirë në shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, sipas kuptimit të ligjit përkatës të fushës së bujqësisë, duke reduktuar normën e tatimit mbi fitimin nga 15% në 5%; nxitjen e bizneseve që janë të licencuar dhe të operojnë në fushën e agroturizmit, duke reduktuar normën e tatimit mbi fitimin nga 15% në 5%; të shkallëzojnë normën e tatimitfitimit për bizneset me të ardhura deri në 14 milionë lekë, ku norma e tatimitfitimit propozohet të jetë 5% e fitimit para tatimit. Ndërsa norma e tatimitfitimit për bizneset me të ardhura mbi 14 milionë lekë propozohet të mbetet 15% e fitimit para tatimit. Thënë ndryshe, përfitojnë 91% e bizneseve nga 0% deri në 5%.

Projektligji ka për qëllim të ndryshojë skemën e tatimeve në industrinë e ndërtimit, me qëllim shpërndarjen e drejtë të barrës fiskale ndërmjet investitorit dhe pronarit të truallit; të unifikojë dhe të harmonizojë ligjin “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhur mbi bazën e tatueshme dhe normën e tatimit mbi lojërat e fatit për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit; të bëjë të mundur harmonizimin ndërmjet dispozitave të ligjit nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Këto projektligje janë në programin analitik dhe në politikat e qeverisë për vitin 2018.

Dua të ndalem në disa pika. Mendoj se ky ndryshim do të ketë efektet e tij.

Sektori i bujqësisë përbën një ndër sektorët bazë të ekonomisë shqiptare. Zhvillimi dhe modernizimi i tij do të ketë impakt edhe në sektorët e tjerë prioritarë për vendin, sikurse është industria e turizmit, e cila e ka të nevojshme bashkëpunimin me një sistem bujqësor, që është në gjendje të garantojë furnizimin me produkte bujqësore dhe blegtorale në sasi, cilësi dhe kohë. Ndërkohë, një sektor bujqësor i kompozuar nga fermerë individualë, me ngastra të vogla toke dhe prodhim minimal për treg, nuk është në gjendje të plotësojë kërkesat e konsumatorëve dhe, për më tepër, ato të një industrie, siç është turizmi. Gjithashtu, është e vështirë që prodhuesit individualë të jenë faktor i rëndësishëm për rritjen e eksporteve të produkteve bujqësore. Për këto arsye është e domosdoshme të rritet shkalla e kooperimit në

bujqësi, një ndër format e së cilës janë shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor. Por rritja e kooperimit të fermerëve dhe krijimi i këtyre shoqërive kërkon edhe stimuj nxitës. Në këtë kuptim, krahas masave të tjera nxitëse të sektorit bujqësor, sikurse janë subvencionimet, investimet në kullim, në ujitje, në infrastrukturë, në energji elektrike e të tjerë, është e arsyeshme që nxitjes së kooperimit dhe krijimit të njësive të mëdha prodhuese bujqësore t'i shërbejë edhe një normë tatimi mbi fitimin e reduktuar për këto shoqëri: një TVSH e reduktuar apo heqja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Sektori i agroturizmit do të jetë, gjithashtu, një ndër prioritetet e vendit, me qëllim zhvillimin e turizmit në zonat rurale, e shoqëruar kjo me nxitjen e prodhimit dhe tregtimit të produkteve lokale në zonë. Në këtë këndvështrim, iniciativa e ndërmarrë synon nxitjen, krijimin dhe rritjen e këtij biznesi, i cili pritet të ofrojë: akomodim, ushqim, çlodhje, argëtim dhe veprimtari të tjera të lidhura me fermën bujqësore.

Projektligji parashikon për këtë kategori biznesesh norma të reduktuara të tatimit të fitimit. Ndryshimi i skemës së tatimit të investitorit dhe pronarit të truallit në ndërtim synon të tatojë në mënyrë të drejtë pronarët e truallit dhe investitorët, që operojnë në fushën e veprimtarive të ndërtimit dhe shitjes së ndërtesave, në të gjitha rastet kur trualli transferohet nga pronari i tokës, sipas një kontrate këmbimi të tokës me sipërfaqet e ndërtimit.

Duke parë se këto projektligje synojnë nxitjen e veprimtarisë pritëse të certifikuar si agroturizëm, asetet, resurset që ka vendi ynë për zhvillimin e këtyre sipërmarrjeve në tërësi dhe atij të agroturizmit në veçanti, të cilat sjellin rritjen e punësimit në zonat rurale, rritjen e të ardhurave dhe konsumit për komunitetin, ju ftoj, të nderuar kolegë, t'i votojmë këto projektligje.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Bushaj!

Fjalën e ka kërkuar ministri Niko Peleshi.

Niko Peleshi – Faleminderit, e nderuara zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar deputetë,

Në fakt, dua të them vetëm dy-tri fjalë shkurtimisht, që më tepër janë falënderime për disa iniciativa, që sot janë në prag të mbështetjes dhe të formalizimit përmes votës suaj. Jam i

bindur, por, për fat të keq, mungon opozita, këto iniciativa nuk janë për një pjesë të shqiptarëve, por për të gjithë Shqipërinë, që janë vështirësisht të kundërshtueshme dhe, natyrisht, të papolitizuara, sepse, së pari, siç e thashë, prekin hapësirën rurale të vendit, që është pothuajse 90% e territorit të vendit, dhe pothuajse zë gjysmën e popullsisë, atë që jeton në fshat.

Në fakt, paketa për agroturizmin nuk është një paketë që prek pozitivisht vetëm jetën e fshatit, por është edhe një mundësi për të ndërtuar një trend të ri, një hapësirë të re biznesi për sipërmarrësit e rinj apo të vjetër. Pra, qëllimi është që ta kthejmë agroturizmin nga një fjalë, që deri dje ishte e papërdorur, e panjohur, si koncept për ekonominë shqiptare, përveç disa iniciativave sporadike, që i ngjasojnë apo i afrohen agroturizmit, në një nënsektor të rregulluar, siç e kemi sot, që e shpjegoi ministri i Turizmit (kemi një komision për agroturizmin, të ngritur në Ministrinë e Turizmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; kemi një rregullore për agroturizmin, kemi një përkufizim të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave).

Me dy fjalë: “agroturizëm” quhet një strukturë me gjashtë deri në tridhjetë dhoma, që ka një restorant shërbimi, pra gastronomik, ka edhe një fermë bujqësore, blegtorale apo akuakulture bashkëngjitur. Pra, sot, që flasim, e kemi kthyer agroturizmin në një nënsektor të rregulluar, por duhet që ta bëjmë atë edhe interesant.

Kjo paketë vjen sot pas një konsulte me legjislacionin e vendeve që kanë pasur sukses në agroturizëm dhe pa dyshim Italia është një nga modelet më të mira botërore të agroturizmit. Çfarë ka ndodhur në Itali para 25 vjetëve, në fillim të viteve '90? Në Itali u miratua një paketë e ngjashme fiskale. Ata përgjysmuan TVSH-në dhe tatimfitimin për strukturat e agroturizmit. Nga viti në vit pati një trefishim të numrit të strukturave agroturistike, ndërsa sot në Itali ka 22 mijë struktura agroturizmi. Madje vitin e kaluar në Itali, në vitin 2017, pati 7 milionë prenotime në strukturat e agroturizmit.

Në qoftë se pretendojmë të kemi 1% të kësaj madhësie të këtij nënsektori në Itali, i bie që në vendin tonë, nga 3, 4, ose 5 struktura agroturizmi, të kemi brenda mandati tonë politik, le të themi, brenda tre vjetëve, disa dhjetëra, pse

jo edhe disa qindra struktura të tilla në të gjithë Shqipërinë, sepse incentiva fiskale që po miratojmë sot është tejet agresive. Tatimi i vlerës së shtuar nga 20% shkon në 6%; tatimi mbi fitimin nga 15% shkon në 5%; taksa e ndikimit në infrastrukturë shkon zero. Pra, me këto tri ndryshime, të investosh në fshat, të ndërtosh një strukturë agroturizmi, duke pasur parasysh edhe diversitetin e madh që ka Shqipëria, ndonëse është një vend i vogël, ka shumë krahina me shumë zakone; ka shumë legjenda, ka shumë mite, të cilat mund të kthehen në një ofertë për turizmin vendas dhe të huaj.

Kemi ende shumë shqiptarë që nuk e njohin Shqipërinë, që do të jenë baza e një turizmi domestik të agroturizmit, por kemi edhe shumë të huaj, që duan të zbulojnë një vend të mrekullueshëm, por pak të njohur, si Shqipëria.

Në fund të fundit, unë e kam thënë dhe do ta them vazhdimisht, ndonëse duket pak jokorrekte politikisht, në fshatin shqiptar është e pamundur të flasim për mirëqenie dinjitoze në qoftë se nuk do të ndërtojmë ekonomi të tjera plotësuese krahas bujqësisë. Toka bujqësore në fshat është mesatarisht 1,2 hektarë, pra një sipërfaqe e pamjaftueshme për të ndërtuar mirëqenie në fshatin tonë, sado përpjekje të bëjmë ne dhe sado të modernizohet dhe të komercializohet bujqësia.

Atëherë, rruga që po ndjekim ne është forcimi i bujqësisë shqiptare nëpërmjet rritjes së mbështetjes financiare, nëpërmjet inkurajimit të bashkimit, dhe këtu dua të kaloj te një incentivë tjetër, që është ulja e tatimfitimit për kooperimet, pra për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, të cilat i kemi përjashtuar nga TVSH-ja dhe tani po e ulim tatimfitimin dhe po e pjesëtojmë me tre, duke e çuar në 5%. Pra, nga njëra anë, është mbështetja financiare për bujqësinë, inkurajimi i modeleve, që funksionojnë dhe sjellin më shumë të ardhura, që krijojnë ekonomi shkalle, siç është kooperimi në shitje, jo kooperimi si kooperativat klasike të kohës së shkuar, por një kooperim i orientuar nga kërkesa e tregut; kurse, nga ana tjetër, kemi krijimin e dy-tri ekonomive të tjera jobujqësore në fshat, të cilat komplementojnë, pra plotësojnë, të ardhurat e familjes fermere.

Natyrisht, kryesor është agroturizmi. Në vendin tonë kemi suksese të strukturave të ngjashme me agroturizmin apo, le të themi, agroturistike, që kanë krijuar një shëndet lokal

ekonomik jo vetëm për atë që e ka investuar, por për dy, tre apo më shumë fshatra rreth e rrotull. Pra, duam të “martojmë” konceptin e agroturizmit me konceptin e marketimit më të mirë të prodhimeve tipike, tradicionale, për të cilat po bëjmë edhe një ligj, që do ta sjellim shumë shpejt në parlament, me modelin tonë të zhvillimit në fshat, nëpërmjet programit “100 fshatrat”, pra të lidhim këto pika dhe të ndërtojmë një ide që funksionon. Në fakt, kjo është një gjetje e zgjuar, për mendimin tim, sepse fshati ka nevojë për miliarda euro investime. Në qoftë se do të bënim një shumatore të të gjitha nevojave bazike, që nga rruga, ujësjellësi, kanalizimet, shërbimet publike, shkollat, qendrat shëndetësore, për të cilat fshati shqiptar ka nevojë, në fund fare do të dilte një faturë e papërballueshme.

Rruga që ne kemi zgjedhur është nëpërmjet modeleve.

Me programin “100 fshatrat” duam të ndërtojmë modele, ku familja fermere ka të ardhura të shtuara nga miradministrimi i tokës bujqësore dhe mbështetja e ekonomisë bujqësore ka të ardhura të shtuara nga agroturizmi që ne inkurajojmë dhe mbështesim të zhvillohet atje, si dhe nga inkubatorët e prodhimeve tipike, të cilët u japin mundësi familjeve fermere të tregtojnë prodhimet e zonës me çmim me vlerë të shtuar edhe në kanalet e tregut, për të cilat nuk dua të zgjatem, por realisht jemi duke punuar dhe brenda këtij viti do të kemi rezultatet e para shumë interesante.

Shfrytëzoj rastin të njoftoj edhe një herë të gjithë të interesuarit se thirrja nga Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural për investime në bujtina dhe agroturizëm është e hapur deri në datën 15 korrik. Pra, kush do që ta kthejë shtëpinë e tij, me së paku katër dhoma, në një bujtinë apo vend akomodues për turistë vendas apo të huaj, përfton deri në 15 milionë lekë në qoftë se aplikon në AZHBR, kurse për strukturat e agroturizmit, të cilat i përkufizova edhe pak më lart, deri në 100 milionë lekë. Pas pak javësh ne do të hapim edhe thirrjen e IPARD-it, ku janë parashikuar 11 milionë euro për diversifikimin e ekonomisë në fshat.

Pra, sot nuk na mungojnë burimet e domosdoshme financiare për zhvillimin rural, por na duhet të punojmë për të investuar në konceptet e duhura, të drejta dhe të ngremë

kapacitetet e fermerëve, investitorëve dhe të gjitha institucioneve tona, në mënyrë që këto para të mund të absorbohen. Kemi eksperiencat e vendeve përreth, të cilat i kanë pasur dritaret e financimit të hapura, por nuk kanë mundur dot të përthithin investimin. Të mësojmë edhe nga gabimet e të tjerëve, por edhe nga përvojat më të mira.

Për shembull, zhvillimi i turizmit duhet të bëhet jo vetëm duke shfrytëzuar bregdetin dhe duke u kthyer kurrizin fshatrave të mrekullueshëm të territorit të Shqipërisë, me kaq shumë potencial dhe kaq shumë trashëgimi kulturore, por edhe duke ndërtuar një model turizmi, që kombinon turizmin e bregdetit, vende-vende masiv, atje ku ka mundësi ta mbajë, me turizmin që mund të zhvillohet në thellësi të vendit tonë, të një vendi ende të pazbuluar.

Jemi mbrapa shumë vendeve të tjera në fushën e turizmit, por populli thotë se çdo e keqe e ka një të mirë. Në rastin tonë, prapambetja e ka të mirën se mund të përfitojmë nga gabimet dhe modelet e suksesshme të atyre që janë disa hapa para nesh.

Shumë faleminderit për mbështetjen!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Peleshi!

Zoti Roland është tërhequr.

Këtu mbyllen diskutimet për të tria projektligjet që lidhen me paketën fiskale.

Kalojmë në diskutimet në emër të grupeve parlamentare.

Fjalën e ka Blerina Gjylameti.

Blerina Gjylameti - E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Sot po diskutojmë për disa ndryshime të paketës fiskale, të cilat vijnë si reflektim ndaj kërkesave të vazhdueshme të grupeve të interesit, por jo vetëm; të shoqatave të biznesit, por mbi të gjitha si reflektim i asaj çfarë kemi thënë në krye të herës.

Në fillim të mandatit tonë të parë ne thamë se do të ndërmerrnim një sërë reformash strukturore të ekonomisë, për ta kthyer ekonominë në shinat e zhvillimit të qëndrueshëm, duke bërë ndryshime të konsolidimit fiskal dhe duke ndërhyrë në sektorët kyç të ekonomisë, me qëllimin e vetëm që të nxisnim punësimin, zhvillimin e ekonomisë dhe të kishim më shumë mirëqenie për qytetarët.

Sot duhet të ishim në një sallë plot, pasi ndryshimet që sjell kjo paketë fiskale prekin shumë qytetarë; prekin ata që e kanë pak më afër zhvillimin, si qendrat urbane të zhvilluara. Kjo pakete që mbështet zhvillimin e agroturizmit çon në zhvillimin e zonave të thella, pra, jo vetëm turizmin e përhershëm, atë bregdetar, por, mbi të gjitha, edhe atë malor.

Sot ne kemi sjellë një sërë ndryshimesh në paketën fiskale, të cilat janë në vazhden e ndryshimeve të ndërmarra që në fillim të mandatit.

Fillimisht e nisëm me lehtësimin e barrës së taksave për qytetarët, duke arritur të bënim atë që premtoam, taksimin e ndershmë. Pra, paguan më shumë ai që fiton më shumë dhe më pak ai që fiton më pak. Vazhduam më tutje të mbështesnim ata sektorë të ekonomisë, që karakterizojnë ekonominë tonë, që është biznesi i vogël dhe i mesëm. Bëmë zero taksën për biznesin e vogël dhe nuk fituan pak, por gati 90% e bizneseve në Shqipëri.

Sot vijmë me një tjetër zhvillim. Kemi ulur në 5% tatimfitimin për bizneset me xhiro nga 8 milionë deri 14 milionë lekë. Këtu duhet të ishim të dyja krahët për ta mbështetur, sepse përfitojnë 10867 biznese. Ne e dimë që në ato biznese ka shumë të punësuar dhe ndikimi nuk është thjesht numerik, por janë më shumë të ardhura për të gjithë ata që kanë votuar për të pasur një qeveri të përgjegjshme, e cila nuk funksionon sipas asaj çfarë ka ndodhur më parë, pra, nxitje vetëm të sërës së atyre që i kanë përkrah, por në mbështetje të atyre që kanë votuar për të parë ndryshim në Shqipëri. Ndryshimi po vjen.

Sot duhej të ishim më shumë, sepse reflektimi është bërë mbi kërkesat e vazhdueshme, që nuk janë të pakta, që nga viti 2006, kur shoqatat e ndërtuesve kërkonin të ndryshohej një nga nenet, që e konsideronte kalimin e pronësisë nga pronarët e truallit tek ata që ndërtonin përsëri si pjesë të tatimit mbi fitimin. Këtu duhet të ndalemi pak dhe të shikojmë se sa ndikon kjo në një sektor tjetër kyç të ekonomisë shqiptare, sikundër është ndërtimi.

E thashë që në fillim, është një politikë e përgjegjshme, e cila nis fillimisht me reformat strukturore për të konsoliduar ekonominë, një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, e më pas

kalon nga mbështetja për biznesin e vogël në mbështetje për biznesin e madh, nga 15% në 5% të tatimfitimit për bizneset me xhiro nga 8 milionë deri 14 milionë lekë, më pas në ulje të tatimfitimit për të gjitha shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, të cilat do t'i nënshtrohen tatimfitimit 5% me synimin e vetëm që të nxisim ekonominë e shkallës pasi, ashtu sikundër janë sot, nuk përfitojnë siç duhet, dalin me çmime shumë më të larta në treg dhe për këtë shkak nuk mund të kemi eksporte.

Ajo që duhet diskutuar dhe duhet ta kemi në vëmendjen tonë, ka të bëjë me ndryshimet e sjella, që kanë të bëjnë edhe me pjesën e një sektori shumë të rëndësishëm, që e përmenda pak më parë, të agroturizmit, ku lehtësojmë tatim-fitimin nga 15% në 5% për një afat kohor 10-vjeçar. Janë struktura akomoduese, të cilat sot janë të pazhvilluara në vendin tonë.

Në kuadër të paketës fiskale, por jo vetëm, edhe të ndryshimeve që janë ndërmarrë edhe më parë, ne vazhdojmë të lehtësojmë dhe të nxisim të gjitha ato biznese të cilat sigurojnë punësim dhe të ardhura.

Kemi edhe disa ndryshime, që janë në vijim të paketës fiskale. Në mënyrë të posaçme, njëra prej tyre ka të bëjë me nenin 8/1, të ardhurat e përjashtuara. Mbas një diskutimi të gjerë dhe të gjatë në Komisionin e Ekonomisë, përsëri kolegët e opozitës, përveçse penguan zhvillimin e punimeve, nuk kontribuan aspak.

Por këtu kemi një problem, i cili ka qenë ndër vite. Ne e riformulojmë këtë nen pikërisht me synimin e vetëm që të ardhurat e realizuara nga kalimi i të drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar te një fermer tjetër apo person fizik ose juridik, që kryen aktivitet bujqësor, të përjashtohen nga tatimi jo vetëm në këtë rast, por edhe në rastin e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore burrë-grua-fëmijë, nëpërmjet dhurimit apo heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh pikërisht nga bashkëpronësia e detyrueshme, e fituar nëpërmjet ligjit nr. 7501 për tokën.

Gjithashtu, një element tjetër ku ne duhet të kemi vëmendjen, është që të gjitha këto ndryshime të vijnë në vazhden e nxitjes së atyre sektorëve, që sjellin punësimin dhe nxisin e përmirësojnë situatën në ato zona që preken më pak.

Do të doja të përmendja edhe një fakt tjetër. E përmendi ministri i Bujqësisë, po ashtu edhe ministri i Turizmit, janë një sërë masash të ndërmarra, që synojnë nxitjen e atyre sektorëve që deri më sot kanë qenë më pak të mbështetur, por nga ana tjetër kanë një ndikim shumë të madh në pjesën rurale dhe në mënyrë të posaçme në punësimin e të gjithë atyre që jetojnë në zonat rurale.

Duke ftuar të gjithë kolegët e maxhorancës ta votojnë projektligjin, ju falënderoj!

(Duartrokitje në sallë)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Këtu përfundon diskutimi për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, për projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, si dhe për projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar”.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, te projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Zonja nënkryetare e Kuvendit,

Besoj se jo vetëm kolegët dhe kolegët janë në dijeni, por i gjithë opinioni publik e ka kuptuar se për çfarë bëhet fjalë. Pra, bëhet fjalë thjesht për një ndryshim afati, për t'u mundësuar studentëve ekselentë, që mbarojnë studimet e larta për drejtësi, të vijnë në karrierën e tyre studimore në nivelin më të lartë të studimeve, në magjistraturë, për shkak se në vitin 2016, kur ne kemi votuar të gjithë, me 140 vota, i është vënë afati 2-vjeçar dhe meqenëse (edhe për pak javë) Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk janë ngritur ende, kërkohet të bëhet një amendim për të rivendosur një afat tjetër, me qëllim që ata studentë, djem e vajza shqiptarë, e ritheksoj, ekselentë, që duan të vazhdojnë studimet për magjistraturë, të mund të regjistrohen në këtë vit shkollor, që fillon në vjeshtë të këtij viti.

Për transparencë të publikut, sot, zyrtarisht, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, dua t'u bëj edhe një herë thirrje

kolegëve deputetë, në radhë të parë, deputetëve të Lëvizjes Socialiste për Integrim, të cilët e kanë votuar këtë projektligj, por nuk nguroj t'i bëj thirrje çdo deputeti të Partisë Demokratike, atyre që e kanë votuar paketën e reformës në drejtësi, edhe atyre që nuk kanë pasur mundësi të jenë këtu më 22 korrik të vitit 2016, të votojnë sepse, nëse ka një pikë nga reforma në drejtësi, që nuk ka pasur asnjë lloj debati, ka qenë pikërisht Shkolla e Magjistraturës. Për çështjen e Shkollës së Magjistraturës gjithmonë ka mbizotëruar konsensusi i plotë.

Kështu që çdo lloj makinacioni për t'iu shmangur kësaj përgjegjësie që kemi të gjithë bashkë, nuk i gjej dot asnjë përgjigje, nga ana e deputetëve të opozitës.

Zonja nënkryetare,

Kolege e kolegë deputetë,

Nisur nga fakti që ky është një ligj që kërkon shumicë të cilësuar, por edhe për të vijuar të njëjtën frymë konsensuale për reformën në drejtësi, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste kërkoj shtyrjen e diskutimit dhe të votimit të këtij projektligji për seancën pasardhëse, atë të datës 19 korrik, siç është përcaktuar me konsensus edhe nga Konferenca e Kryetarëve dhe miratuar nga seanca e shkuar plenare.

Faleminderit!

(Duartrokitje në sallë)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Balla!

Atëherë, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shtyhet për seancën tjetër plenare.

Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, te projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e Sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka deputeti Xhemal Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Kjo është një marrëveshje që ka të bëjë me rritjen e sigurisë kombëtare në vend. Unë jam i bindur se, pavarësisht bojkotit, opozita do ta miratojë këtë projektligj, sepse u shërben interesave kombëtare. Edhe Shqipëria, si çdo

vend tjetër, mund të jetë e kërcënuar nga rreziqe të lidhura me terrorizmin, prandaj, në këtë kuadër, del si domosdoshmëri që të ketë një konsolidim dhe solidaritet jo vetëm politik, por edhe qytetar, për qasje në koncepte, kapacitete, infrastrukturë dhe stërvitje mbarëkombëtare, duke pasur një teknologji bashkohore në rritjen e besimit dhe në zinxhirin komandues. Në këtë kuadër vjen edhe kjo marrëveshje, për të cilën gjej rastin të falënderoj, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për nënshkrimin e marrëveshjes, që ka të bëjë drejtpërdrejt me përmirësimin e kushteve dhe me rritjen e masave të sigurisë, kryesisht në pikat e kalimit kufitar.

Çfarë thuhet konkretisht dhe cili është qëllimi i kësaj aktmarrëveshjeje?

Me anë të kësaj marrëveshjeje ngrihet një sistem, i cili konsiston në rritjen e elementeve të sigurisë, kryesisht te pikat e kalimit kufitar. Elementi kryesor është ai i të dhënave biometrike, të cilat identifikojnë edhe rastet më të vështira, pasi edhe sistemi aktual, duhet ta pranojmë, nuk është në nivelin dhe cilësinë e duhur. Gjithashtu, instalimi i këtij sistemi do të shoqërohet edhe me një rinovim të infrastrukturës, duke pajisur çdo punonjës me kompjuter, lexues për dokumente, lexues për gjurmët e gishtave, kamera dhe me kontrollin e fytyrës. Këto do të sjellin një përmirësim të dukshëm të rritjes së masave të sigurisë.

Çfarë është e detyruar të bëjë pala jonë në këtë marrëveshje dhe në këtë memorandum?

Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë ka për qëllim ta vendosë në punë dhe ta administrojë këtë sistem, të mirëmbajë pajisjet e sistemit, të parashikuara posaçërisht për qëllimet e specifikuar në përputhje me legjislacionin shqiptar “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, gjithashtu, t'u garantojë qytetarëve shqiptarë dhe shtetasve të huaj, që vizitojnë Shqipërinë, një marrëveshje ndërkombëtare, që lidhet me zbulimin dhe ndalimin e personave që janë ndaluar ndërkombëtarisht. Të dyja qeveritë synojnë të bashkërendojnë përpara çdo transferimi zhvendosjen e mjeteve dhe të pajisjeve kompjuterike të këtij sistemi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Shqipërisë,

Kjo marrëveshje është në favor të sigurisë kombëtare dhe ka një vlerë rreth 5 milionë dollarë amerikanë. Marrëveshja do të fillojë implementimin e saj si fillim në pikën kufitare të aeroportit të Rinasit dhe më pas do të shtrihet në të gjithë sektorët e tjerë.

Nuk e quaj të udhës të vazhdoj më tej, pasi kjo është një gjë shumë pozitive. Duke vlerësuar rëndësinë e saj dhe përfitimet e shumta që i sjellin shtetit shqiptar, shpreh mendimin dhe dakordësinë se kjo marrëveshje do të miratohet dhe do të marrë votë unanime nga të gjithë deputetët.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Qefalia!

Këtu mbyllet diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”.

Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, që është projektligji “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

Në emër të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, përsëri fjalën e ka zoti Xhemal Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Në fakt, të gjitha marrëveshjet janë standarde dhe mendoj se kjo marrëveshje, ashtu siç është nënshkruar nga shumë shtete të Bashkimit Europian, normalisht edhe nga qeveria shqiptare, ka të bëjë kryesisht me luftën e migrimit të paligjshëm dhe masat për parandalimin e tij.

Kjo është një sfidë që po bëjnë të gjitha vendet e Bashkimit Europian dhe, në këtë kuadër, duke qenë se është një marrëveshje standarde, nuk më mbetet gjë tjetër vetëm të shpreh dakordësinë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për t’u miratuar.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Qefalia!

Këtu mbyllet edhe lista e projektligjeve për diskutim.

Kemi 5 minuta pushim. U lutem të gjithëve kolegëve deputetë të vijnë në sallë, sepse do të kalojmë në votim.

(Rifillon seanca)

(Drejtimit e seancës e merr zoti Ruçi.)

Gramoz Ruçi - Të futen mediet!

Rifillojmë seancën!

Hapet votimi për prezencën!

Ju lutem, hiqni kartat e zotit Sterkajt, zonjës Hoxha, zotit Angjeli, si dhe të ministrave Gjignuri dhe Bushati!

Mbyllet votimi. 72 deputetë janë prezent.

Fillojmë me votimin e raportit vjetor të veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2017. Bëhet një votim elektronik i hapur.

Hapet votimi!

Mbyllet votimi!

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te votimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”.

Hapet votimi me elektronikë në parim!

Mbyllet votimi!

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen të projektligjit.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3, me vërejtjen për pikën 4. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi!

Hapet votimi me elektronikë!

Urdhëroni, zoti Ministër!

Arben Ahmetaj – Për sa i përket taksimit të trashëgimisë së tokës bujqësore, pra bie ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbi të ardhurat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu është. Këtë po pyes, a është përfshirë, apo jo?

Gramoz Ruçi – Është përfshirë tek togfjalëshi “me vërejtjet e komisionit”. Kjo u miratua.

Arben Ahmetaj – Me vërejtjet e komisionit pa këtë amendament, që është paraqitur këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pyes, sepse dua të jem i qartë se çfarë kalon.

Gramoz Ruçi – Jemi te projektligji i parë, zoti Ministër.

Arben Ahmetaj – Dakord.

Gramoz Ruçi – Vazhdon votimi, zoti Ahmetaj!

Mbyllet votimi!

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Hapet votimi me elektronikë në parim!

Mbyllet votimi!

71 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen të projektligjit.

Kemi vërejtjet e propozuara nga komisioni përgjegjës. Do të ndalemi edhe tek amendimi i deputetëve Erion Braçe dhe Evis Kushi.

Para se të fillojmë me nenin 1, dua t’ju them se është depozituar amendimi i këtyre 2 deputetëve, 24 orë para fillimit të seancës plenare, për riformulimin e pikës 5 të nenit 1.

Kush do të shprehet për këtë propozim nga nismëtarët?

Urdhëroni, zoti Braçe!

Erion Braçe – Zoti Kryetar,

Amendimi nuk bën gjë tjetër, vetëm sa barazon statusin fiskal të resort - hoteleve me 4 dhe 5 yje me statusin fiskal të njërive të agroturizmit. Ky është amendimi.

Gramoz Ruçi – Urdhëroni, zoti Ahmetaj!

Arben Ahmetaj – Ne e kemi diskutuar edhe në komision, që qeveria është shprehur kundër. Argumentimi është fare i thjeshtë.

Së pari, jemi duke folur për dy gjëra të ndryshme. Resort - hotelet me 4 dhe 5 yje janë një terren fiskal i kontrolluar. Nuk kemi prodhim brenda këtyre strukturave, gjë që e komplikon akoma më shumë porozitetin e situatës fiskale të njësive të agroturizmit. Shuma e investimeve në të dy nënsektorët brenda turizmit është e ndryshme. Në rastin e resort - hoteleve me 4 dhe 5 yje, siç e theksova edhe në fjalën time, bëhet fjalë për një investim prej mbi 10 milionë eurosh, ndërsa në rastin e njësive të agroturizmit investimi është më modest, ndërkohë që aprovohet një strukturë subvencioni, që e ka drejtpërdrejt Ministria e Bujqësisë, edhe nëpërmjet udhëzimit të përbashkët që kemi firmosur me *cash* në dorë nga qeveria për njësitë e certifikuar të agroturizmit.

E fundit fare, që e kam ndarë edhe me Kryeministrin, edhe me grupin parlamentar, edhe me kryetarin e Komisionit të Ekonomisë, të cilin e falënderoj për mbështetjen e vazhdueshme, edhe me këtë komision, duhet të jemi gardianë të sistemit fiskal, sepse një shthurje e vogël sjell shthurje të mëdha. Në rastin konkret, jam i bindur që profesionalisht dhe në ndjeshmëri të plotë fiskale edhe komisioni bie dakord me mua me këtë gjë.

Do t'ju lutesha ta tërhiqni këtë amendament! I kërkoj grupit parlamentar dhe kryetarit të tij, ta tërheqin.

Gramoz Ruçi – Fjalën e ka kryetari i grupit!

Taulant Balla – Së pari, dua të theksoj edhe një herë që të tria këto projektligje, që përbëjnë paketën fiskale që kalon sot, kanë një rëndësi të veçantë. Gjej rastin të falënderoj Komisionin e Ekonomisë për mënyrën se si i shqyrtoi dhe se si i pasuroi këto 3 projektligje me disa angazhime të rëndësishme tonat politike përkundrejt sektorit të turizmit në tërësi dhe në mënyrë të veçantë, të agroturizmit, që ka të bëjë me secilën prej zonave zgjedhore, të cilat ne kemi nderin t'i përfaqësojmë në Kuvend.

Thënë gjithë kjo, edhe propozimi që vjen nga kolegët Braçe dhe Kushi është një propozim konkret, i cili hedh një hap të rëndësishëm, por

dua të theksoj se ne kemi marrë garancitë e nevojshme edhe nga qeveria, edhe nga ministri, që ky do të jetë një hap i dytë që do të reflektohet në një hap tjetër të ndryshimeve fiskale, të cilat janë incentive të rëndësishme që mbështesin agroturizmin. Kështu, propozimi im drejtuar deputetëve të të gjitha krahëve, është që ky amendament të abstenohej sot, por me *footnote*-n që, zoti Ministër, kjo do të jetë një prej detyrave që do të reflektohet në të ardhmen në paketat fiskale, që do të shqyrtohen.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Kalojmë në votimin e amendimit me kartonë!

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Votojmë nenin 1, me vërejtjet për riformulimin e pikës 5 të tij, sipas variantit të komisionit!

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi!

Hapet votimi me elektronikë në tërësi!

Mbyllet votimi!

71 vota pro. Kundër? 1 kundër. Abstenim? Asnjë.

Miratohet.

Kalojmë te projektligji "Për një shtesë në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar"

Hapet votimi me elektronikë në parim!

Mbyllet votimi!

71 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te votimi nen për nen i projektligjit.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi!

Hapet votimi me elektronikë në tërësi!

Mbyllet votimi!

71 vota pro.

Miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”.

Hapet votimi elektronik në parim!

Mbyllet votimi!

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen të projektligjit.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi!

Hapet votimi me elektronikë në tërësi!

Mbyllet votimi!

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”.

Hapet votimi me elektronikë në parim!

Mbyllet votimi!

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te votimi nen për nen i projektligjit.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi!

Hapet votimi me elektronikë në tërësi!

Mbyllet votimi!

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, të cilin e kemi lënë nga seanca e kaluar.

Urdhëroni, zoti Balla!

Taulant Balla – Faleminderit, zoti Kryetar!

Meqenëse komisioni nuk e ka shqyrtuar ende amendamentin që kemi depozituar unë dhe zoti Manja, propozojmë të kalojmë për në seancën pasardhëse.

Gramoz Ruçi – Seancën tjetër?

Taulant Balla – Po.

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Më lejon të njoftoj përfundimet e mbledhjes së Sekretariatit për Procedurat dhe Votimet të Kuvendit. Sipas Rregullores dhe rekomandimit që bëra në fillim të seancës, sot u mbledh Sekretariati për Procedurat dhe Votimet për të shqyrtuar ankesën e grupeve parlamentare të opozitës për anulimin e votimit të projektligjit “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: “Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar””.

Sekretariati i Kuvendit të Shqipërisë për Procedurat dhe Votimet, pasi zhvilloi mbledhjen për shqyrtimin e kësaj kërkesë, thirri në seancë dëgjimore deputetin Robert Bitri dhe administratën e Kuvendit. Pas diskutimeve vendosi, me shumicë votash ta rrëzojë kërkesën e paraqitur nga kryetarët e grupeve parlamentare të Partisë Demokratike dhe të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në lidhje me anulimin e votimit të projektligjit “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: “Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar””.

Së dyti, konstaton të vlefshme procedurën e votimit për projektligjin në fjalë. Argumentet e Sekretariatit janë si vijojnë: “Procedura dhe votimi janë të sakta dhe të vlefshme. Ky votim është i bazuar në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit për kuorumin dhe për shumicën e votimit. Votimi ka qenë i hapur, ka qenë elektronik dhe me ngritje dore, sipas nenit 58 të Rregullores “Për votimin nen për nen dhe në tërësi”. Asnjë deputeti të Kuvendit nuk i është mohuar ushtrimi i të drejtës së votimit dhe shprehja e vullnetit. Rezultati i votimit nuk ka ndikuar dhe nuk ndikon në vendimmarrjen

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 9 KORRIK 2018

përfundimtare të Kuvendit, Sekretariati i Kuvendit”. Unë e konsideroj të drejtë vendimin e tyre.

Seanca mbyllet.

Seanca tjetër do të njoftohet me mjetet e informimit publik.

Faleminderit!

(Seanca u mbyll në orën 13:00)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**